

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



**Ekstrakti nga procesverbali, mbledhja e katërt - IV e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 30.04.2024, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës, e ndërprerë dhe vazhduar me datën 13.05.2024 dhe 16.05.2024.**

**Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës:** Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete. Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Fidan Berisha, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Shpend Bardiqi, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

**Mungon:** Habib Mekolli në mbledhje me datën 30.04.2024.

**Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës:** Besnik Osmani - Nënkryetar i Komunës, Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Fatlum Berisha - Drejtor për Arsim, Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Infrastrukturë, Mimoza Kolshi - Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ali Topalli - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, Ardit Sekiraqa - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ilir Hasani - Drejtor për Gjeodezi Kadastër e Pronë, Vjosa Kida Hyseni - Drejtore e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Arbër Statovci - Drejtor për Inspektorat.

**Të tjera:** Ejup Qyqalla - Shef për Shërbime Publike dhe Merita Krasniqi - Shefe për Buxhet dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

#### REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 31.01.2024.
2. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023.
3. Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar të komunës për vitin 2023.
4. Informatë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për funksionimin e Kuvendit të Komunës në tre mujorin e parë të vitit 2024.
5. Propozim për ndryshim-plotësimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.
6. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Fushë-Kosovë.

7. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
8. Shqyrtimi i kërkesës për ndërrimin e anëtarit në Komisionin Komunal të Aksionarëve, në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave Pastrimi.
9. Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Shkollës së Futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël.
10. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
11. Të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Përshëndeti të pranishmit në mbledhje. Lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe hapi diskutimin për pikat e rendit të ditës.

**Durim Hajra:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kohë e fundit nuk është duke shkuar mirë puna në Kuvendin e Komunës, është fjala për pikën e rendit të ditës ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’. Nëse kenë vullnetin me e ndal zërin e opozitës kjo është kundër nesh, kryesues edhe ju po jeni kundër nesh, edhe pse kemi qenë dhe jemi kolegë për disa vite, kjo është një ofendim. Kërkesa jonë është që kjo pikë ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, të jetë pika dy e rendit të ditës, siç ka qenë më parë. Kryetari i Komunës nuk është prezent në mbledhje dhe nuk kemi as një përgjigje nga ai.

**Mirsad Qyqalla:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje, kur të hiqet kjo pikë e rendit të ditës duhet të kemi një përgjigje por nuk e kemi atë, kjo është shumë e çuditshme. Në arsyetim thuhet se është koha, koha ka qenë e respektuar gjithnjë. Pika ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, duhet të kthehet në pikën dy të rendit të ditës, siç ka qenë më parë, sepse puna jonë po mohohet. Duhet të rishikojnë qëndrimin, ata që janë përgjegjës, mos ta minojnë punën e Kuvendit, e mos ta përdorin ligjin në mënyrë selektive, kur dhe si ju duhet atyre. Edhe kjo të mohohet, nuk tolerohet kjo punë është e pa pranueshme.

**Hasan Ismaili:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Sa i përket heqjes së pikës ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, kjo është një manipulim, këtë të drejtë e përcakton Ligji për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 39 të tij. Unë kërkoj që të shtohet një pikë e rendit të ditës, e që është një marrëveshje me dy Bashkësitë Fetare, e kjo marrëveshje është bërë vetëm me Kryetarin e Komunës. Kërkoj që të na tregon se si është lidhë kjo marrëveshje, kjo është një marrëveshje e jashtëligjshme e Kryetarit të Komunës me dy Bashkësitë Fetare.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Unë jam që të zbatohet Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2024 dhe pika ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, të mbetet aty ku ka qenë. Në kemi përgatitë disa rregullore, e nuk kemi arrit që t’i implementojmë e fokusi im është të shqyrtohen këto, unë kam problem që të bashkohem me Ekzekutivin e Komunës në këtë pikë, pra në pikën ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, unë dua që të jenë në rend dite. Ne e kemi një rend të ditës, nëse kemi vullnet i fusim në rend të ditës pyetjet dhe përgjigjet parlamentare në pikën dy. Kemi marrë një propozim nga Grupi Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës që pika ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, të jetë pika e parafundit.

**Laureat Gojnovci:** Ne e kemi një rend të ditës me propozimin që të kthehet kjo pikë e rendit të ditës si pikë e parafundit, ne kemi pika të tjera që duhet të diskutohen më parë.

**Durim Hajra:** Ju i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës duhet të vendosësh për disa çështje. Ekzekutivi i Komunës nuk mund të ndërhyjë në punën e Kuvendit, ne kemi votuar një plan pune

këtu në Kuvend, prandaj duhet zbatuar atë plan, ta ktheni pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', aty ku ka qenë e të shkojmë përpara.

**Mirsad Qyqalla:** Ideja që Shefat e Grupeve Parlamentare, të thirren në bisedime është tendencioze, nëse dëshirojmë sinqerisht të thirren grupet punuese, dhe t'i si Kryesues i Kuvendit të Komunës nuk është dashtë me lejuar që të hiqet kjo pikë e rendit të ditës. Një argument është që drejtorët i kemi këtu vetëm paradite, ketë punë e dimë të gjithë. Ju me sulmuar këtë pikë, nuk është normale, por është e qëllimshme.

**Hasan Ismaili:** Te pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ne jemi dakorduar që me 'Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024', kjo pikë e rendit të ditës të jetë si pikë e dytë e rendit të ditës. Interesi im është që ta dijë, se pse kthehemi në këtë pikë të rendit të ditës për diskutim, nëse dakordohemi kjo pikë të jetë nën pikën dy.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim 'Propozimin që pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', të jetë si pikë e dytë e rendit të ditës, e propozuar nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje.

U votua me: njëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej njëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se propozimi i Lëvizjes Vetëvendosje nuk kalon.

Opozita në shenjë të shprehjes së pakënaqësisë proteston para tavolinës së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, duke e penguar mbarëvajtjen e rregulltë të punës së Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Kërkon pesëmbëdhjetë minuta pushim. Pas këtij pushimi Kryesuesi informon që patëm një takim konsultues me Shefat e Grupeve Parlamentare dhe fokusi aty ishte që të lejohet mbajtja e mbledhjes, por ne nuk mundem që të unifikohemi për këtë pikë të rendit të ditës, aty qëndrimi i Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ka qenë që kjo pikë e rendit të ditës të jetë si pikë e parafundit.

**Laureat Gojnovci:** Më vjen keq për këtë situatë të krijuar, por ne jemi të gatshëm që ta vendosim këtë pikë të rendit të ditës kah fundi i shqyrtimit të pikave tjera të rendit të ditës. Propozimi i Grupeve Parlamentare të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Partisë Demokratike të Kosovës, nuk i ka marrë votat e mjaftueshme që kjo pikë të jetë si pika dytë e rendit të ditës. Por edhe tani ne jemi të gatshëm që kjo pikë e rendit të ditës të jetë e parafundit për mbledhjen e sotme. Nëse mundet dikush nga ana e Ekzekutivit të Komunës, të ndikon te Drejtorët e Drejtorateve të Komunës, që të qëndrojnë deri në fund të mbledhjes, ne për këtë punë jemi të gatshëm.

**Durim Hajra:** Është Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës, që është argumentë për rrjedhën e punës së Kuvendit, ky Kuvend është dritarja e fundit, që kërkesa jonë për kthimin e pikës 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', në vendin e saj tek pika dy e rendit të ditës.

**Mirsad Qyqalla:** Ky ndryshim në radhitje për pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ka filluar para dy mbledhjeve, ku ne e kemi shprehur pakënaqësinë dhe qëndrimin tonë, madje edhe me lëshim të mbledhjes, por askush nuk është marrë me rregullimin e kësaj çështje, jeni ju ata që po e bëni të pamundur vazhdimin e mbledhjes, duke përdorur arrogancën e numrave. Këtu kërkesa jonë është që kjo pikë e rendit të ditës të kthehet aty ku ka qenë, sepse për dy vite me radhë ka

qenë si pikë e dytë e rendit të ditës, pra edhe tani të vazhdohet me praktikën e njëjtë, ne vazhdojmë të jemi aty ku kemi qenë.

**Hasan Ismajli:** Ne në takimin tonë konsultues nuk gjetëm dakordim në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, ne kemi qenë model për dy vite në nivel vendi, nuk e dijë kush e kërkon këtë përplasje, e kush e ka marrë një vendim të tillë arbitrarë. Arsyeja që mbledhjet e Kuvendit të Komunës po vazhdojnë pesë deri në gjashtë orë, kjo punë nuk është asnjë problem, sepse disa punëtorë në komunë vijnë 22 ditë në muaj në punë dhe paguhen vetëm nga 300.00€, andaj ne duhet të zhvillojmë mbledhjet e Kuvendit të Komunës, për disa orë, qoftë edhe tetë orë në ditë. Unë kërkoj që të ruhet qetësia, ashtu sikur kemi qenë në të kaluarën.

**Laureat Gojnovci:** Ky është një propozim i Ekzekutivit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe këta e kanë të drejtën e plotë, të caktimit të pikave të rendit të ditës për shqyrtim në mbledhje.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Unë jam që ta interpretoj këtu Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës, por kjo po shkelet dhe ne kemi shqyrtuar së bashku çështjen e mbarëvajtjes së mbledhjes, ky është një propozim dhe Kuvendi i Komunës është organi më i lartë që vendos për këtë punë. Ne e kemi propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, që pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare' të jetë e fundit, unë e respektoj vetëm Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe punoi sipas saj.

**Artan Asllani:** Ne kemi të thirrur vetëm përfaqësuesit e subjekteve politike, por jo secilin përfaqësues të subjekteve politike në Kuvend, por pyetjet tona nuk po kemi kujt t'ia drejtojmë tani këtu në mbledhje.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Opozita është që pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', të jetë nën pikën dy të rendit të ditës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim 'Propozimin e Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, që pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare' të jetë e parafundit.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës, me shumicë të votave e aprovuan 'Propozimin e Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, që pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare' të jetë e parafundit.

Opozita fillon të proteston para tavolinës së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, duke e kapur mikrofonin dhe duke e penguar punën e rregullt të Kuvendit të Komunës.

Në situatën e krijuar pas protestimit të opozitës dhe shprehjes së pakënaqësisë nga ana e tyre Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim rendin e ditës.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës, me shumicë të votave e aprovuan rendin e ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme.

### **Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 04.04.2024**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim dhe aprovim 'Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 04.04.2024', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të japin vërejtjet apo sugjerimet e tyre.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më datën 04.04.2024'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', gjashtë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më datën 04.04.2024'.

### **Koha e pushimit prej një ore.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Pas kalimit të kohës së pushimit dhe kthimit në mbledhje, opozita prapë nuk lejon punën e rregulltë të vazhdimit të mbledhjes së Kuvendit të Komunës, pas kësaj situate të krijuar prapë Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e ndërprente mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe thekson se do të ju njoftoi me kohë, për vazhdimin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës.

### **Mbledhja ndërprehet në orën 13.15 minuta.**

### **Vazhdimi i mbledhjes së ndërprerë me 13.05.2024, ora 10:00h.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Përshëndes të gjithë të pranishmit në mbledhje. Ne tani do të vazhdojmë mbledhjen e ndërprerë me datën 30.04.2024, pas të cilit e kemi patur një takim konsultues me Shefat e Grupeve Parlamentare dhe subjekteve tjera politike së bashku me Nënkryetarin e Komunës me datën 07.05.2024, për të cilat fakte ju jeni vetë të informuar, andaj nuk dua të përsëris këtu çështjet e njëjta, ne do të vazhdojmë punën tani me rendin e ditës së aprovuar, po ashtu e dijm qëndrimin e shprehur të secilit Grup Parlamentarë veç e veç, por edhe të subjekteve tjera politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës në mbledhjen e datës 30.04.2024, po ashtu e kemi të njohur edhe dakordimin tonë për pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', me 'Planin e Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024', kjo është një përmbledhje e rrjedhës dhe veprimeve në këtë mbledhje, andaj tani do të ftoi të japin deklaratimet e tyre Shefat e Grupeve Parlamentare.

**Laureat Gojnovci:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani u dha një lloj përmbledhje e rrjedhës së mbledhjes së Kuvendit të Komunës, që ne si pjesëmarrës të saj, e kemi të njohur, tani unë në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim për zbatim marrëveshjen e dakorduar për vazhdimin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës, të ndërprerë sipas rendit të ditës, me pranimin e kërkesës që pyetjet të jenë në fund të rendit të ditës.

**Durim Hajra:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kolegët tonë e kanë sqaruar, shprehjen e pakënaqësisë, në diskutimet e tyre, por kjo punë është dashur të përshkruhet në një fletë A 4, ose

në një procesverbal, unë e kam paraqitur në atë takim me juve i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, pastaj edhe me Shefat e partive politike nga pjesa e Kuvendit të Komunës dhe Nënkyetarin e Komunës në takimin e përbashkëta për vazhdimin e mbledhjes, diskursin tim në emër të Lëvizjes Vetëvendosje me katër pika, që duhet të garantojnë shkurt që: pika e pyetjeve dhe përgjigjeve parlamentare të jetë në fund të rendit të ditës, po ashtu që Ekzekutivi i Komunës, të krijon kushte për mbarëvajtjen e mbledhjes, të respektohet ana e strukturës dhe tavolinës së punës së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, për të mos u përsëritur veprimet e njëjta apo të tjera parlamentare nga ana e jonë, por duhet të respektohet nga të gjithë dakordimi i arritur në takimin tonë.

**Mirsad Qyqalla:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani këtu u theksua nga kolegët dakordimi ynë në parim për vazhdimin e mbledhjes, duke i zbutur edhe qëndrimet tonë në funksion të vazhdimin të punës së rregullt të Kuvendit të Komunës, me respektimin e praktikave të mira parlamentare, por duke mos i kufizuar të drejtat tona, u tha se duhet të ruhet sipas rregullave hapësira - tavolina e punës së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, si një vend i punës së tij, por ne kërkojmë që të krijohen kushte të punës, të cilat tani nuk janë. Tani për të sqaruar dhe informuar opinionin, duhet të rregullohen kushtet për punë normale në sallën e Kuvendit të Komunës, të rregullohen mikrofonat nga ana e Ekzekutivit të Komunës, për mbarëvajtjen e rregullt të punës së Kuvendit të Komunës, të respektohet marrëveshja parimore nga ana e të gjithëve dhe të vazhdojmë me punën tonë, me kërkesën time që ta kemi një prezencë të kënaqshme të Drejtorëve të Komunës në periudhën e ardhshme tremujore, ndërsa deri në vjeshtë të punohet për krijimin e kushteve të punës.

**Hasan Ismajli:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë nuk do të përsëris fjalët që u thanë nga kolegët, sepse të gjithë kemi qenë pjesëmarrës, pajtohem plotësisht se duhet të ruhet hapësira e punës së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, të krijohen kushtet për punë normale, të respektohet marrëveshja e dakorduar për mbarëvajtjen e punës së Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Jemi dakorduar që pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare' të jetë prezent në rendin e ditës në fund të mbledhjes, të garantohet për periudhën e afërt tre mujore një prezencë e kënaqshme e anëtarëve të Ekzekutivit të Komunës në mbledhje, të krijohen kushtet për punë në sallën e Kuvendit të Komunës, si dhe e kemi arritur një dakordim që të zbatohet dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës dhe praktikatat e mira parlamentare.

#### **Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 04.04.2024**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim dhe aprovim 'Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 04.04.2024', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të japin vërejtjet apo sugjerimet e tyre, sepse tani këtë pikë do ta rikthejmë edhe njëherë në votim për arsye të lëshimeve teknike në procedura me datën 04.04.2024, ku është theksuar se numri i votave nuk ishte i saktë, meqë kishte lëvizje të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në votimin e mbledhjes së datës 30.04.2024.

**Hasan Ismajli:** Unë e kam një vërejtje në faqen 22 të ekstraktit të procesverbalit të datës 04.04.2024, ku e kam cekur kohën e pauzës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, e cila fillon nga ora 09:00h - 09.30 minuta, kam kërkuar që



edhe për këtë kohë të gjindet një mënyrë e përshtatshme për trajtimin e pacientëve, më keni fajësuar për diskutimin tim, keni bërë kthimin e kamerave atje, unë vetëm kam thënë se është një rastë urgjentë dhe duhet të trajtohet, kam thënë se e dorëzoi mandatin tim dhe kërkoi falje publike, nëse nuk kam thënë, ashtu sikur e kam pohuar vetë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, ju e keni incizimin e mbledhjes, mund ta shikoni dhe verifikoni vetë, por në mënyrën e drejtë dhe autentike ashtu sikur e kam thënë, e jo me interpretime të ndryshuara.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më datën 04.04.2024'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', gjashtë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më datën 04.04.2024'.

## **Pika e dytë 2 - Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023'. Hap diskutimin.

**Jetmir Berisha:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në raportin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023, e keni të përmbledhur punën, aktivitetet dhe projektet e realizuara publike nga trembëdhjetë Drejtori të Komunës, unë do të përmendi punët e kryera nëpër disa drejtori, ku Drejtoria e Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës ka realizuar një mijë e nëntë dhjetë e nëntë kërkesa, e ka një realizim të tyre prej 96%, pastaj Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, ka arritur të grumbulloi të hyra vetjake nga tatimi në pronë prej: 1.4 milion, që paraqet një rritje prej 55% krahasuar me vitin e kaluar, nga Drejtoria e Arsimit është punuar shumë në dixhitalizimin e shkollave tona, është në ndërtim shkolla e re, është bërë renovimi i shkollave, njësoi janë të shënuara shumë qartë edhe punët dhe projektet e Drejtorive tjera të Komunës, janë shumë projekte të filluara të kontraktuara vitin e kaluar, të cilat vazhdojnë në teren, nëse nuk kemi vonesa në bartjen e buxhetit nga niveli qendror pritet të realizohen. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, punën dhe projektet e realizuar nga Kryetari i Komunës së bashku me kontributin dhe angazhimin e secilës Drejtori të Komunës në vitin 2023, ne e vlerësojmë pozitivisht dhe urojmë që projektet e filluara të realizohen, në funksion të rritjes së mirëqenies dhe kushteve të jetesës për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës.

**Durim Hajra:** Secilin vitë e kemi një përshkrim të punëve të komunës në letër nga Kryetari i Komunës, i cili për gjashtë vite sa jam unë anëtarë i Kuvendit të Komunës, asnjëherë nuk ka ardhur në mbledhjet e Kuvendit, për ta prezantuar raportin e punës së tij, madje ai këtë raport jam i bindur se as nuk e lexon, vetëm e nënshkruan, madje nuk konsultohet për realizimin e programit të tij, as me partnerët e kualicionit në qeverisje, ku në rastin tonë si komunë, është bartur si i pa shfrytëzuar 110% e buxhetit për projekte kapitale, andaj unë ju sfidoi juve shumicën këtu në Kuvendin e Komunës, për të diskutuar dhe analizuar secili projekt të buxhetuar dhe rrjedhën e realizimit të tij.

**Mirsad Qyqalla:** Tani këtu e kemi në shqyrtim dhe analizim raportin e punës një vjeçare, i cili dorëzohet në shqyrtim në Kuvendin e Komunës, ky raport i punës nuk votohet, andaj nuk i kushtohet ndonjë kujdes nga përgjegjësitë e punës, por as nga hartuesit e tij, përshkruhen shumë punë dhe aktivitete të realizuara nëpër shërbime administrative sipas kontratave të punës, që

ndoshta edhe nuk ka nevojë fare të jenë pjesë e një raporti të punës, nuk paraqiten sfidat në realizimin e programit të premtuar para qytetarëve. Për të krijuar terr informativ dhe mbyllje të mëtejme, është tentuar të hiqen nga rendi i ditës edhe pyetjet, të gjithë ne këtu duhet ta ngrisim nivelin e diskutimeve profesionale, sidomos kur shqyrtohen raporti i punës dhe raporti i shpenzimit të buxhetit, por meqë ai na nën vleron neve si anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe as kur shqyrtohet raporti i punës së tij, nuk e merr mundin të vjen në mbledhje, madje kur e shikon raportin dhe ndarjen e subvencioneve nga Drejtoritë përkatëse sikur është Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, ku paraqiten disa sfida në raport, por këtu përkrahen Organizata Jo Qeveritare dhe individë që kontribuojnë për pushtetin, me shumë të mëdha të mjeteve financiare, pa ndonjë raportim apo sqarim për publikun të shpenzimeve të tyre, qoftë edhe përmes raporteve të punës, përfitues janë emrat e njëjtë në secilin vitë, mirëpo meqë ai Kryetari i Komunës po na injoron neve, edhe ne nuk do të marrim pjesë në diskutimin përmbajtësore të këtij raporti, do të veprojmë njësoi, meqë jemi të detyruar të veprojmë kështu njëjtë, pa fajin tonë, ndërsa do të duhej të ishte krejtësisht ndryshe, kur diskutohet puna një vjeçare dhe shpenzimet, për projekte publike, sfida e realizimit të tyre, ndarja e subvencioneve, ndikimi i tyre, por edhe shpenzimet tjera publike, nëpër kategori tjera ekonomike.

**Aida Alimi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023, është i njëjtë paraqet përshkrimin e detyrave të punës së zyrtarëve komunal, nuk është e drejtë që të bëhet kjo fyerje ndaj Kuvendit të Komunës, të mos paraqitet puna dhe sfidat, të diskutohen ato në Kuvendin e Komunës, të na sqarohet neve, çka është arritur në punët publike në interesin e qytetarëve, çka është realizuar nga programi i premtuara para qytetarëve, çka ka mbetur pa u realizuar, të na sqarohet raporti i prokurimit për projekte publike, kush është penalizuar për projektet e pa realizuar, a është ndëshkuar ndonjë operatorë ekonomik, për punën e pa kryer, të sqarohet çka kanë punuar Drejtoritë e caktuara komunale, kjo është një sjellje e pa përgjegjshme e një Kryetari të Komunës, me mos prezencën e tij, që po ndodh në këtë shekull, është për tu habitur, që nuk meriton as të komentohet nga ana jonë.

**Nënkryetari i Komunës:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani ju para vetës e keni një raport të punës së Kryetarit të Komunës, që ju është dorëzuar për shqyrtim dhe analizim, këtu prezentë jam unë dhe Drejtorët e Drejtorateve të Komunës për t'iu dhënë juve sqarime, për kërkesat tuaja me sqarimet tona shitesë. Në këtë raport të punës tonë një vjeçare, i cili është gjithëpërfshirës dhe shumë i detajizuar me punë dhe aktivitete të kryera të natyrës administrative, shërbimet e ofruara për qytetarë, projektet e realizuara, në fund e keni pjesën e prokurimit publikë, ku janë kontratat e realizuara dhe projektet e kontraktuara, që vazhdojnë të realizohen edhe gjatë këtij viti. Në aspektin administrative kemi rritje të kërkesave prej 15%, të cilat janë duke u kryer me kapacitete të njëjta humane, por me një përkushtim të lartë, ne e kemi theksuar se jemi një komunë e pasur, me shumë punë e aktivitete dhe shumë zhvillim, por me buxhet të kufizuar nga rregullat e buxhetimit publik me formula aktuale buxhetore, e marrim buxhetin me regjistrimin e para trembëdhjetë viteve. Këtu vlen të theksohet se disa projekte kanë qenë në procedura në Organin Shqyrtues të Prokurimit, tani jemi në kontraktime publike për realizimin e disa projekteve të mëdha, ku hyn projekti për realizimin e trajtimit të ujërave të zeza në shumën e mjeteve financiare prej: 1.9 milion euro me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, për rregullimin e kolektorit për rreth 450.000 mijë banorë, por edhe projektin e rregullimit të rrjetit të ujit për qytetarët tonë, vetëm këtu kemi investime publike në shumën e mjeteve financiare prej: 3.6 milion euro, pastaj



në arsim jemi duke i ndërtuar dy shkolla të reja dhe dy çerdhe publike në shumën e mjeteve financiare prej: 1.4 milion euro, këto projekte shkojnë në dy vite dhe përfshinë projeksionet buxhetore dy vjeçare, janë projekte me shuma të mëdha, në fushën e sportit kemi investime prej: 2 milion euro, me ndërtimin e Palestrës së Sportit për sportistët tonë dhe në rindërtimin e Stadiumit të qytetit, pastaj në fushën e ambientit tani do të investohen rreth 700,000.00€, ka qenë një perceptim se mjedisi është keqë në komunën tonë, kjo punë nuk qëndron, kur kësaj shume i shtohen edhe këndet e lojërave dhe hapësirat e gjelbërta, shuma arrin në një milion euro investime publike për mjedisin. Tek shërbimet kemi problem me mirëmbajtjen, e keni parë se e kemi bërë mbushjen e gropave, ndoshta jo në mënyrën e duhur, por për të krijuar kushte më të mira për qytetarët tonë në zonën urbane, kemi bërë mbushjen e gropave, me punëtorët tonë që i kemi në dispozicion. Tani jemi në një trend pozitiv, i kemi rritur investimet kapitale nga 26% në vitin 2022, në 41% në vitin 2023, treguesit e performancës kanë treguar një rritje krahasuar me vitin paraprakë, të hyrat vetjake kemi arritur t'i grumbullojmë dhe ato do t'i shfrytëzojmë për realizimin e projekteve të mira publike për qytetarët e komunës tonë, diskursi politikë këtu është shumë negativ, por ne si komunë jemi duke punuar shumë për krijimin e kushteve më të mira në arsim, shëndetësi dhe shërbime komunale, me investime publike në renovimin e shkollave, ku bënë pjesë edhe ndërtimi i shkollës së re, renovimi i brendshëm dhe i jashtëm i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, përmirësim të mëtejme të shërbimeve publike, me kapacitetet e limituara administrative si rezultat i ndarjes së buxhetit për komunën tonë.

**Durim Hajra:** Unë në deklarin tim i nderuari Nënkyetar i Komunës, e theksova atë që ne nuk marrim përgjigje në shumë pyetje tona, ju e përmendët diskursin politikë, por nuk na sqaruar neve sa është arritur vizioni juaj për zhvillim, 70%, apo sa, me shembuj konkret, unë e potencova mënyrën e raportimit për gjashtë vite me radhë këtu në Kuvendin e Komunës, këtu e kemi një përshkrim të punës së zyrtarëve komunal, dihet cilat janë kompetencat e Kryetarit të Komunës, me premtimet publike që i ka dhënë ai gjatë fushatës matet performanca. Indeksi i transparencës neve na vendos në fund të tabelës me komunat serbe, ju i përmendet në mënyrë kronologjike investimet në arsim, shëndetësi dhe sport, që nuk janë kryer ende në teren, ndërsa në shkollat tona mësimdhënësit nuk kanë as letër A 4, pastrohet me batanije, infrastruktura dhe ambienti nuk janë në gjendje të mirë, mungon sheshi i buxhetuar me vite në lagjen e Dardanisë, që nuk është realizuar asnjëherë, ju theksuat se janë duke u bërë investime milionëshe, atëherë pse janë grumbulluar 6 milion euro të pa shpenzuara dhe që barten, nga viti në vitë për shpenzim.

**Mirsad Qyqalla:** Po jemi dobët në performancë, ju po thuani se kemi ngritje, por në tabelën e performancës jemi në fund së bashku me komunat e komunitetit serbë. Unë nuk dua të mohoi punën që bëhet në interesin e qytetarëve, tani në fshatin Sllatinë e Vogël tek pishat janë duke u mbjellur drunjë, ka filluar edhe rindërtimi i Stadiumit të Qytetit, folët edhe për ujin, ne projekteve të mira publike i gëzohemi, por rregullimi i problemit të furnizimit me ujë të pishëm nuk është rregulluar për më shumë se dhjetë vite nga ana e juaj, edhe pse vetë e keni premtuar, tani i ka ardhur radha Lëvizjes Vetëvendosje, që nëpërmjet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ta bëjë këtë punë, ky Kryetar i Komunës me Ekzekutivin e tij dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, i ka lënë fshatrat e komunës së Fushë-Kosovës pa ujë për njëzet vjet. Të hyrat vetjake i paraqitet si një sukses, dihen rregullat dhe kufijtë që vendosen nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për grumbullimin e tyre, ju theksuat se me këto mjete financiare jemi duke e ndërtuar dhe zhvilluar komunën tonë. Drunjët dekorativ në sheshin, apo rrugën e Dardanisë janë duke u

mbjellur në mes të trotuarit, sepse Drejtoria e Inspektoratit nuk vepron në atë zonë, nuk i pengon, nuk vepron ndaj bizneseve që i kanë vendosur terasat e tyre në hapësira publike. Te urbanizmi dhe infrastruktura realitetit në teren e tregon të kundërtën, gropat në rrugë janë mbushur me rërë, mënyra e kryerjes së kësaj pune ka qenë e turpshme. Për ambientin, gjendja nuk është mirë, nuk na keni dhënë asnjëherë ndonjë informatë të detajizuar për ngecjet në themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale, që e kemi votuar në Kuvendin e Komunës në fillim të mandatit tonë, deri tani nuk ka ndonjë përparim në këtë drejtim. Megjithatë në këtë fushë Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' ofron disa shërbime të mira, gjendja në fshatra është e mirë, ndërsa në qytet ka telashe të mëdha, kontejnerët e vendosur në pika të caktuara largohen, mungon veprimi i komunës dhe vendoshmëria e saj në këtë fushë.

**Vlonjat Hasani:** Përhëndes të pranishmit në mbledhje. Tani unë të jem i sigurt për këtë raport të punës, është edhe e vështirë të japësh ndonjë vlerësim, sepse ka përshkrim të punës dhe aktiviteteve ditore të zyrtarëve komunal, ju e dini protestimin tonë simbolikë me datën 30.04.2024, kur u tentua që nga rendi i ditës të hiqen pyetjet, që ne i kemi aprovuar në mënyrë unanime në Kuvendin e Komunës, kur e kemi miratuar 'Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024', këtu ndërhyri tani Nënkryetari i Komunës dhe e paraqiti suksesin e Ekzekutivit të Komunës lidhur me projektet kapitale, që e theksoi se ne nuk po e shohim, ai i paraqiti si suksese disa projekte publike, që janë në proces të realizimit të tyre, sikur është projekti për shtrimin e rrjetit për furnizim me ujë të pishëm, që po realizohet tani nga Qeveria e Kosovës, u tha se janë rreth dy milion euro investime në sport për rregullimin e Palestrës së Sporteve, por investimet tuaja publike në Sallat e Sportit nëpër fshatra janë bërë shumë keqë, me shumë lëshime dhe keqë përdorime, investimi i parasë publike ka shkuar dëm, është dëmtuar buxheti dhe askush nuk ka shkuar në burg, këto janë sfidat që duhet të jenë pjesë e raportit të punës, ambienti është në gjendje shumë të keqë, duhet të turpëroheni me mbeturinat në disa zona dhe mirëmbajtjen e ambientit, gjendjen e lumenjëve e cila nuk monitorohet nga askush, pastaj ju duhet ta shikoni vetëm rrugën 'Arbëria' në qytet dhe hyrje/daljet e autostradës në rrugën e Pejës. Duke e lexuar raportin e Drejtorisë së Inspektoratit e sheh, se leje mjedisore janë 20, procesverbale 34, inspektime 95, ndërsa nga e gjithë kjo punë gjobat janë zero, kjo punë nuk don koment fare.

**Hasan Ismajli:** Të flasim për raportin e punës nuk ja vlen, kur Kryetari i Komunës nuk e merr mundin fare që për katër vjet të vjen në Kuvendin e Komunës, por këta kjo është çështje është personale, sepse këta e kanë bërë zhvoshjen e fruteve të pushtetit në kundërshtim me mandatin e marrë nga qytetarët, por këtu duhet të kemi ballafaqim politikë nëpërmjet ideve për të adresuar sfidat dhe problemet e qytetarëve. Projekti për shtrimin e rrjetit për furnizim me ujë të pishëm, është projekt i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Në Stadiumin e Qytetit po investohet së bashku me Federatën e Futbollit të Kosovës, ku komuna investon 250,000.00€, por nuk e dijmë a është e rregulluar çështja pronësore, sepse stadium nuk është në pronësi komunale, është në pronësi të Agjensisë Kosovare të Privatizimit, ne nuk e dijmë, a do të rrezikohet ky investim publikë, sepse në portale këtij investimi i keni dhënë shumë publicitet, së bashkë me pjesën e Ekzekutivit të Komunës, i nderuari Shef i Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Investimi në projektin për mbjelljen e drunjëve dekorativ në rrugën e 'Dardanisë', është duke u realizuar edhe në rrugët tjera jashtë planifikimit buxhetor, një dru dekorativ kushton 470 euro, mbjellja e tyre tani po bëhet edhe në rrugët tjera, sepse nuk ka mundësi të mbillen të gjithë në rrugën 'Dardania', ku tani janë duke u mbjellur në trotuare, sepse ju nuk mund të lironi hapësirat

nga uzurpimet me terasa prej bizneseve, që operojnë në këtë rrugë, tani aty nga zënia e hapësirës së trotuareve, pritet të kenë pengesa, nënat që bartin me karroca fëmijët e tyre dhe sidomos personat tjerë me aftësi të kufizuara. Çështja tjetër është, çka do të ndodh në të ardhmen me këndet e lojërave që janë në ato hapësira. Në shkollën 'Daut Bogujevci' pastrimi bëhet me batanije, në të njëjtin objekt shkollorë ku mësojnë edhe nxënësit serb dhe rom, pastrimi bëhet me makinë, ju duhet të na sqaroni pse po ndodh kjo punë.

**Fisnik Sllamniku:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024, paraqet një përshkrim të mirë për të gjitha shërbimet komunale që ofrohen dhe paraqet një vlerësim për certifikimin e punës së mirë të Administratës Komunale, pastaj përshkruan projektet kapitale të realizuara dhe ato në realizim, ju këtë raport të punës nuk duhet ta kuptoni vetëm si statistikë, unë më tepër do të ndërlihem tani me fushën e arsimit, tani secila shkollë nga investimet e komunës i kanë llap-topët dhe projektorët për punë në secilën klasë, në shkollën 'Selman Riza', kjo punë është kryer para dy viteve, është bërë vitin e kaluar edhe renovimi i shumicës së shkollave, kemi edhe aparatura për pastrimin e ujit, që kanë një vlerë prej një mijë e gjashtë qind euro. U folë për pastrimin me batanije në shkollë, tani po ndodh, se disa punëtorë teknik nuk e kanë ndjekur kursin për përdorimin e mjeteve të punës, pra makinave për pastrim, të cilat janë të reja, këtu shumica e qëndrimeve sa i përket disa ngjarjeve, më shumë janë llafe dhe diskurs politikë, i perceptcionit të tyre nga këndi opozitarë. Parimisht unë jam që projektet kapitale të monitorohen, por shkollat tona tani janë të furnizuara me mjete teknologjike të punës, të cilat ua kanë lehtësuar shumë punën mësimdhënësve.

**Hasan Ismajli:** Tani anëtar i Kuvendit të Komunës z. Fisnik Sllamniku, unë të sfidoi të shkojmë edhe në shkolla tjera, në shkollën 'Mihal Grameno', me dy Anekset e saj, në shkollën 'Daut Bogujevci' dhe në Gjimnazin 'Hivzi Sulejmani' në Fushë-Kosovë, ku do të siguroheni se këto fenomene janë duke ndodhur, makinat e ardhura në shkollë nuk janë përdorur. Në Gjimnazin 'Hivzi Sulejmani', është investuar, është bërë një renovim aty, por nuk është bërë në mënyrën e duhur, ashtu sikur është kërkuar.

**Vlonjat Hasani:** Tani këtu dua të ndërlihem me diskutimin e kolegut tim z. Fisnik Sllamniku, çështja e mirëmbajtjes në shkollat tona lënë shumë për të dëshiruar, në shkollat tona mungojnë kushtet elementare për punë, unë deri tani kam qenë pjesë e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport, ne i kemi dhënë rekomandimet e tona pas vizitave në shkolla, por ato nuk janë marrë parasysh, ka pasur shpesh herë edhe probleme të sigurisë në shkolla, që nuk janë trajtuar në mënyrën e duhur.

**Dardane Sogojeva Shala:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me gjendjen në shkolla duhet të ballafaqohen faktet, mësuesit kanë telashe me printimin e testeve, ka mungesë të letrës. Sigurisë në shkollat tona duhet t'iu kushtohet një kujdes i veçantë, ka telashe me hyrjen e automjeteve të prindërve në oborrin e shkollës 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë, ne kërkojmë që nga ora 08:00h - 18.00h, sepse aty fëmijët dalin në rrugë dhe ka shumë rrezik për ta, meqë komunikacioni është shumë i dendur në atë pjesë të qytetit, ka patur raste kur janë thirrur edhe Policia e Stacionit të Fushë-Kosovës për të ndihmuar, ne kërkojmë që të ketë një angazhim të policisë me prezencë, në kohën kur lëvizjet e nxënësve janë më të shumta për të shkuar në shkollë.

**Nënkryetari i Komunës:** Në fakt qëllimi im ishte nxitja e debatit për raportin e punës një vjeçarë të Ekzekutivit të Komunës, ku unë jam kyqur më vonë në pjesën e dytë të vitiut 2023, ne kemi arritur një sukses në realizimin e projekteve kapitale, pas zhblllokimit të buxhetit dhe bartjes në

muajin gusht të vitit të kaluar, ku kemi filluar procedurat e tenderimit dhe kemi lidhur disa kontrata me operatorë ekonomik, vlenë të theksojmë për opinionin se një pjesë e projekteve kapitale janë të mëdha, me shuma mbi një milion euro dhe janë shumë jetike për qytetarët, për sportistët sepse ne po tentojmë, të krijojmë kushte më të mira për aktivitete dhe ushtrime të sportistëve në të ardhmen. Themelimi i Ndërmarrjes Publike Komunale, është bllokuar nga Ministria e zhvillimit Ekonomik, e cila nuk na është përgjegjur pozitivisht, për kundër shkresave tona të dërguara për takime zyrtare, të bërë para nëntë muajve. Tani po e ritheksoi edhe një here, e vërteta është se vitin e kaluar mjetet financiare nga të hyrat vetjake, janë liruar vetëm në muajin gusht dhe ne i kemi patur në dispozicion për zhvillimin e projekteve kapitale vetëm katër muaj, e vërteta e jonë është se ne krahasohemi edhe me komunat tjera në shumë fusha madje jemi edhe më mirë, tani në renditje komunat tjera si ajo e Lipjanit, Obliqit dhe Rahoveci që kanë përqindje të performance 69.63%, edhe ne jemi aty pra tek kjo shifër në realitet si komunë 69.63%, mirëpo këtu vlerësohen tri grupe, demokracia, financat dhe shërbimet publike, te ne problem është transparenca, pjesa te demokracia efektive, demokracia jo efektive, sepse në dhënien e shërbimeve publike komunale, por edhe administrative për qytetarët ne jemi shumë mirë dhe vlerësohemi nga qytetarët e komunës tonë me mbështetje shumë herë në zgjedhje dhe punojmë në vazhdimësi, për përmirësime në të gjitha fushat e kompetencave të nivelit komunal.

### **Pika e tretë (3) - Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar të komunës për vitin 2023.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim ‘Raportin financiarë për buxhetin e shpenzuar të komunës në vitin 2023’, ftoi Shefen për Buxhet dhe Financa që të na jap sqarime shtesë.

**Merita Krasniqi - Shefe e Sektorit për Buxhet dhe Financa:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë si zyrtare në Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit e kryejë edhe punën e Zyrtarit Kryesor Financiar. Tani ju para vetës e keni ‘Raportin financiarë për buxhetin e shpenzuar në vitin 2023’, i cili është në shumën e mjeteve financiare prej: 16,628,215.02€, ky raport financiarë i shpenzimeve është përgatitur në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësiëve, standardeve të kontabilitetit publikë dhe Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Tani granti qeveritarë për vitin 2023 ka qenë në shumën e mjeteve financiare prej: 12,983,107.09€, ndërsa të hyrat vetjake në shumën e mjeteve financiare prej: 3,805,402.00€, për informimin e juaj, që edhe e dini për arsye të bartjes dhe alokimit të buxhetit komunal nga bartja e mjeteve financiare të pa shpenzuara, vitin e kaluar është bërë në muajin korrik dhe gusht të vitit 2023, kjo bartje ka qenë në shumën e mjeteve financiare prej: 6,354,114.03€, që në tatalin e tij e ka rritur buxhetin e komunës në shumën e mjeteve financiare prej: 23,252,916.74€, shpenzimi i realizuar është në përqindje prej 72% e buxhetit final në dispozicion të komunës brenda vitit buxhetore me bartje të buxhetit të pa shpenzuar. Shpenzimi i buxhetit është realizuar ne pesë kategori ekonomike të shpenzimeve, për paga dhe mëditje është shpenzuar shuma e mjeteve financiare prej: 7,972,376.84€, për mallëra dhe shërbime është shpenzuar shuma e mjeteve financiare prej: 2,711,211.28€, për shpenzime të komunalive, ku hyjnë edhe pagesa për ndriçimin publikë është shpenzuar shuma e mjeteve financiare prej: 258,388.43€, për subvencione dhe transfere është shpenzuar shuma e mjeteve financiare prej: 1,481,330.50€ dhe në fund për shpenzime kapitale, pra në projekte publike dhe investime të komunës është shpenzuar shuma e mjeteve financiare

prej: 4,198,465.23€. Planifikimi i të hyrave vetjake ka qenë 3.8 milion euro, ndërsa janë grumbulluar 4.2 milion euro, ose shprehur në shuma 389 mijë euro më shumë.

**Laureat Gojnovci:** Buxheti i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin fiskal 2023, ka qenë në shumën e mjeteve financiare prej: 15,000,000.00€, prej tyre nga granti qeveritarë kanë qenë të alokuara shuma e mjeteve financiare prej: 11,000,000.00€, kësaj shume të buxhetit të komunës i shtohet edhe bartja e buxhetit të pa shpenzuar, në shumën e mjeteve financiare prej: 6,000,000.00€ dhe ky participim në totalin e tij, e sjell buxhetin tonë në 22 milion euro, i cili është shpenzuar për 11% më shumë krahasuar me vitin e kaluar, ose shpenzimi i tij e arrin përqindjen 95% të totalit të tij, pa llogaritur këtu bartjen e buxhetit të vitit 2023, në vitin 2024, që është alokuar për shpenzim vetëm në muajin gusht të vitit 2023. Tani prej këtij buxhetit të bartur me shumë vonesa për shpenzim, komuna ka arritur të shpenzon mbi katër milion euro në projekte kapitale, ku punë publike dhe projekte të kontraktuara dhe në zbatim me operatorët ekonomikë në shumën e mjeteve financiare 4.8 milion euro tjera, vonesat në shfrytëzimin e buxhetit kanë ndikuar të kemi edhe ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Shpenzimet nëpër kategori ekonomike të shpenzimeve u elaboruan shumë qartë nga Shefja për Buxhet dhe Financa, po ashtu e kemi të realizuar përtej planifikimit, edhe një rritje të hyrave vetjake prej 389,000.00€, ku tejkalim në grumbullim është 111% mbi planin e komunës, këto të hyra vetjake vijnë kryesisht nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, sikur e dini shpenzimi i buxhetit nuk votohet, ne në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, i pranojmë këto shpenzime të realizuar në vitin 2023, urojmë që projektet e kontraktuara të realizohen gjatë këtij viti, po ashtu e mbajmë të drejtën e diskutimit të secilit anëtarë të Kuvendit të Komunës nga Grupi ynë parlamentarë, që të diskuton për shpenzimet në lokalitetin e caktuar që shpreh interesin e tij.

**Durim Hajra:** Lidhur me shpenzimin e buxhetit në vitin 2023 nga Ekzekutivi i Komunës, ne i kemi vërejtjet tona si opozitë, shuma e bartjes së buxhetit të vitit 2022, për shpenzim në vitin 2023, prej mbi gjashtë milion euro, është treguesi kryesorë, se ju si pushtet aktual në qeverisje, nuk ua keni kthyerë qytetarëve taksat e grumbulluara, në projekte kapitale me interes publik, tani buxheti komunal me këtë qeverisje jo transparente dhe jo efikase, ka arritur shumën në 23 milion euro, prej tyre 6.6 milion euro nuk janë shpenzuar, 4.8 milion euro janë mjete financiare të zotuar dhe 1.8 milion euro tjera janë mjete të lira financiare, ka një deficit nga granti qeveritarë të madh prej: 529,000.00€. Në shpenzimin e buxhetit për mallëra dhe shërbime, që janë para nga granti qeveritarë ju jeni kampion, sepse këtë e keni kapur si element me rëndësi që duhet të shpenzohet si pjesë e buxhetit, shumën e mjeteve financiare që e keni humbur si të pa shpenzuar në total është një milion euro, ky fakt duhet të ju brengos, sepse këto mjete financiare nuk kthehen në komunë. Në raport me vitin financiarë 2022 në 80% të shpenzimeve prinë asfaltimet që e arrin realizimin e tyre 99%, sepse këtu i keni mundësitë më të mëdha për manipulime, duke u kujdesur që të shtroni me asfalt, edhe nëpër oborre private. Shumë detaje të shpenzimeve nëpër kode ekonomike, kur krahasohen janë të pa arsyeshme si shpenzime në shumën e tyre, në Zyrën e Kryetarit të Komunës për udhëtime zyrtare është shpenzuar shuma e mjeteve financiare prej: 3,672.00€, ne nuk kemi informata se ai ka udhëtuar dikun, apo ka udhëtuar stafi i tij, te kodi ekonomik 1350, mobilje, paisje shpenzimet janë të mëdha, njësoi është edhe për mirëmbajtjen e automjeteve, pastaj kemi edhe shpenzime të përfaqësimit, ne nuk e dijmë ku jemi përfaqësuar jashtë nga Kryetari i Komunës. Në total në vitin 2023 për udhëtime zyrtare është shpenzuar shuma e mjeteve financiare prej: 66,000.00€, shuma prej: 214,000.00€ është shpenzuar për pajisje, për blerje tjera është

shpenzuar shuma prej: 292,000.00€, pastaj rreth gjysum milioni euro është shpenzuar për dru dhe lëndë djegëse, për shpenzime të përfaqësimit është shpenzuar shuma prej: 72,000.00€, për pagesën e vendimeve gjyqësore të arsimit, është shpenzuar shuma prej: 280,000.00€, ku zyrtarët akuzojnë, ndërsa avokatja e komunës pajtohet me kërkesa, kjo është një keqëpërdorim total i buxhetit dhe rritje e shpenzimeve pa nevojë, sepse rritet kosto e shpenzimeve dhe mësimdhënësit detyrohen të shkojnë në procedura gjyqësore dhe përmbartimore. Pjesa e projektit të ndërtesës këtu, është ndërtuar në mënyrën më të keqe, ende pa përfunduar projekti, zyrtarët janë vendosur në katin e dytë të komunës, e ceku vetë Nënkryetari i Komunës se janë duke u bërë ndërtime të objekteve publike administrative e shkollore dhe Palestrën e Sportit, një shumë dikun prej: 3.5 milion euro, normal se kur nuk punohet mirë performance është e keqe, ka një përmirësim vetëm prej 10%, krahasuar me vitin 2022, këtu fakti kryesorë është se llogaridhënia ndaj publikut mungon, keqë menaxhimi i parasë publike po vazhdon, mbi shtatë projekte publike të premtuara nga Kryetari i Komunës në fushatë, nuk kanë nisur fare të zbatohen.

**Mirsad Qyqalla:** Tani interpretimi i shpenzimit të buxhetit nga drejtori z. Ramadan Jashanica më herët dhe Shefja për Buxhet dhe Financa tani dallon shumë, nga zyrtarja u ndanë me neve shumë specifika të shpenzimit të buxhetit me sqarime, unë i kam të pa qarta shpenzimet për dru dhe lëndë djegëse, shpenzimet e mirëmbajtjes, synimi i shifrave dhe të dhënave tjera të shpenzimit të buxhetit nëpër kategori ekonomike dhe kode ekonomike me numra të caktuar, duhet të jetë me sqarime shtesë, e jo e kundërta e saj komplikimi i tyre, unë e kam një bindje se shpërndarja në këtë mënyrë bëhet me një synim, për komplikimin e shpenzimeve nëpër kode ekonomike, që i kanë emërtimet e tyre formale, shpesh herë edhe të njëjta, mirëpo neve duhet të na jepet një shpjegim narrative për shpenzime, në disa kategori të shpenzimeve që në emërtimin e tyre sipas formulimeve janë të njëjta, por duhet të arsyetohen mirë për anëtarët e Kuvendit të Komunës, si organ që shqyrton shpenzimin e parasë publike. Tani e kemi një shpenzim për dru dhe lëndë djegëse tek Drejtoria e Planifikimit Urban, në shumën e mjeteve financiare prej: 18,000.00€, unë e di që ata punojnë me letra dhe rregullore, i njëjti shpenzim figuron edhe te Drejtoria e Inspektoratit është një shumë prej: 6,967.00€, ata nuk shpenzojnë lëndë djegëse për ngrohje, puna e tyre është në teren. Këtu para neve Ish/Nënkryetari i Komunës ka theksuar se kur buxheti nuk mund të realizohet në ekonomi, paraqet një vitë të humbur, unë ju pyes juve, meqë po thuani se buxheti i pa shpenzuar është alokuar me vonesë, a është ky një vitë i humbur edhe për juve, tani është fajtor Qeveria e Kosovës me vonesat e saj, më herët ishte pandemia, pastaj Organi Shqyrtues i Prokurimit, mos gjeneralizoni çështjet, këtu fajtori kryesorë është mos puna e juaj. Shpenzimet për automjete janë në shumën e mjeteve financiare prej: 166,000.00€, ka një mos përputhje këtu në shifra, sepse për mirëmbajtjen e tyre është shpenzuar një shumë prej: 152,000.00€, ndërsa për sigurimin e tyre është shpenzuar shuma prej: 50,726.00€, ne të gjithë i dijm çmimet për sigurimin e automjeteve, nuk i ka komuna jonë një qind, dy qind apo më shumë automjete, për udhëtime zyrtare është shpenzuar shuma prej: 78,000.00€, shuma e humbur nga granti qeveritarë nga Drejtori i Financave dhe Buxhetit, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, na është thënë se është 260,000.00€, ndërsa Nënkryetari i Komunës ka thënë se këto mjete financiare nuk humbin, sepse dy buxhet janë tonët, pra të vendit tonë, kjo punë nuk është kështu në realitet, sepse mjetet financiare të destinuara për shpenzime në Komunën e Fushë-Kosovës, duhet të shpenzohen, të mbesin te ne si e mirë publike, por duhet të realizohen me kohë nga komuna, e jo të humbin, të kthehen në buxhetin e nivelit qendror. Tani nga gjithsej 16 milion euro, sepse më shumë se gjysma shkojnë për paga dhe



shpenzohen, mbesin edhe dikun rreth më rreth 7 milion euro për shpenzime tjera kapitale dhe subvencione, që e kanë një ndikim më direkt, tek qytetarët dhe individët, atëherë edhe këtë vitë mbështetur në shpenzimet e realizuara, mund ta quajmë me plotë të drejtë vitë të humbur, nga mos puna e juaj, sepse puna dhe projektet publike maten në teren. Tani u ndërruan disa drejtor komunal, por nuk ka rëndësi ndërrimi i individit, nëse nuk ndërron mendësia në qeverisje.

**Hasan Ismajli:** Shpenzimet për dru dhe lëndë djegëse të cekura nga kolegët janë të mëdha, unë dua ta paraqes këtu para juve një fakt tjetër, kanë qenë dikun 2971 metra kub dru, në oborrin e komunës për një kohë, të cilat mungojnë tani, ato janë shitur apo ku kanë shkuar unë nuk e di, për këtë punë ka edhe raport zyrtar të përpiluar nga zyrtari kompetentë në këtë rast, detajet tjera të këtij rasti të druve ju i dini shumë mirë, edhe vetë. Tani te Infrastruktura Publike është shpenzuar shuma prej: 33,000.00€ për dru dhe lëndë djegëse, shpenzime të tilla ka edhe te Drejtoria e Urbanizimit, këto dy drejtori kanë punë në teren, nuk harxhojnë dru, ku fakt është thënë nga vetë roja e pyllit, a ka qenë ajo makinë me tabela private apo si unë nuk e di, por automjetet e komunës i kanë tabelat e tyre zyrtare. Shpenzimet e naftës dallojnë nëpër drejtori, në drejtorinë ku është automjeti me numër të regjistrimit 55 - 09, pyes sa harxhon derivate të naftës ky automjet, sepse këtu ka edhe zyrtarë tjerë të ndershëm dhe shumë punëtorë, të cilët shkojnë për bukë në këmbë, ndërsa drejtorët dhe disa zyrtarë shkojnë me automjete zyrtare, andaj rriten shpenzimet e naftës dhe për këtë punë dikush duhet të jap llogari.

**Merita Krasniqi - Shefe për Buxhet dhe Financa:** Raporti është gjeneruar prej sistemit të free - balancit, por ne e mbajmë edhe analitikën, por analitika është shumë voluminoze dhe kjo është arsyeja pse ne kemi shkuar në sub - analitikë. E tash për sqarimin e juaj te kodi i derivative dhe lëndëve djegëse është kodi 1307, i cili përfshin naftë për ngrohje qendrore, drutë, derivatet për gjeneratorë, karburant për automjete dhe gazin natyror, kjo është një pasqyrë financiare. Edhe kur të vijnë pasqyrat financiare ju i shihni kodet pesë shifrorë, ndërsa vetëm për shkak të volumit, ne kemi shkuar në sub - analitikë për ndryshe, nëse e shihni të arsyeshme asnjë problem, nuk ka që ju të vini dhe të shihni secilin shpenzim, e tha Durimi për vendimet gjyqësore është një keqë kuptim me sa duket, sepse Komuna nuk i ekzekuton vendimet gjyqësore, shkojnë në thesar dhe thesari e bën ekzekutimin e tyre.

**Durim Hajra:** Po na po flasim për shkaktarin e këtyre shpenzimeve të mëdha në buxhetin e komunës.

**Merita Krasniqi - Shefe për Buxhet dhe Financa:** Të gjitha detajet i keni këtu në analitikë dhe mundeni me i pa secilin shpenzim.

**Durim Hajra:** Për atë arsye këto janë te ndara sepse totali i shpenzimeve për vendime gjyqësore është në shumën e mjeteve financiare prej: 946,597.03€

**Merita Krasniqi - Shefe për Buxhet dhe Financa:** Tani i nderuari z. Durim, edhe tek deficit nuk ke vlera të sakta, të lutem eja në zyre edhe e hapim para kompjuterit, se nuk i keni shifrat e sakta, sepse ne i kemi në analitikë dhe çdo muaj Komuna barazohet me thesarin, është procesi i barazimit të Komunës me thesarin, asnjë as 0.01 cent nuk mundesh pa u barazuar me thesarin, sepse muajin tjetër nuk mundesh me pasur më pagesa, për këto detaje mundeni me ardh në zyre edhe çdo detaj e keni, përndryshe me kërkesen e juaj materiali do të jetë më i gjerë, e ne mundemi me e bërë edhe këtë. Këto nuk i bëjmë ne por këto ri gjenerohen në sistem informativ të menaxhimit të financave të Kosovës, e jo përmendesh, sikur po flisni ndonjëherë ju për numrat e buxhetit

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Faleminderit znj. Merita Krasniqi, a mundemi me ndëgjuar një replikë të shkurtë e ka Durimi dhe pas Durimi, ta jap prapë fjalën prapë për sqarime z. Hasan Ismajli.

**Durim Hajra:** Është raportit 2022, raporti i shpenzimit, faqja e dytë, e shkruame me kimik. granti qeveritar e ki diferencen 931,481.30€, unë e thashë se viti 2022 dhe 2023, shkojn në një milion euro.

**Mirsad Qyqalla:** Sa janë shpenzimet për dreka dhe darka në Anabenz, në fund të vitit 2023.

**Merita Krasniqi - Shefe për Buxhet dhe Financa:** Të gjitha këto shpenzime janë në kodin 13410 për dreka zyrtare.

**Hasan Ismajli:** Unë e kam një pyetje për hargjimet e kolegut tonë, që ka qenë tre herë në Zvicër, atij i është paguar bileta e Aeroplanit dhe ka marrë mëditje, nga kodi i Kuvendit të Komunës, andaj unë për këtë çështje kërkoi që të kem më tepër sqarime.

**Merita Krasniqi - Shefe për Buxhet dhe Financa:** Kërkoj falje, edhe një herë, shërbimet e Arsimit, trajnimit, janë zakonisht kur shkojnë nëpër trajnime, që thirren prej Ministrise d.m.th kemi ftesa kur ka ndryshim te planit kontabel ose prokurimi dhe te gjitha drejtoritë e tjera. Furnizimi me ushqim dhe pije, zakonisht këto jane ushqimet, furnizimet 13620, shkon për ushqimet në çerdhe, pastaj furnizim me veshmbathje, është për inspektorat e komunës, pastaj sigurimi i ndërtesave është policia që e siguron ndërtesën e komunës, mirëmbajtja rutinore, zakonisht përfshihet zhbllokimi i kanalizimit dhe eliminimi i deponive të egra e tjera. Qiraja për tokë e kemi me Infrakosin, në Miradi të Epërme dhe ne normalisht në bazë të marrëveshjes e paguajmë qiranë, pastaj qiraja për paisjet me keni pyetur. Qiraja për paisjet është qiraja e automjeteve me Automitën, e cila është e lidhur dhe siç e dini të gjithë. Qiraja për përdorime të tjera hapësinore janë rastet sociale, janë këto që i paguan qiranë prej 50 euro, mirëpo tash me planin e ri kontabël, këto nuk paguhen prej mallrave dhe shërbimeve, por kalojnë prej subvencioneve, sepse është përfituese vet pala që ka rast social. Më vjen keq, por këto detaje mua nuk po më kujtohën që kanë ndodhur, ndoshta je i keq informuar, por ne jemi të hapur për të dhënë sqarime për secilin shpenzim.

**Koha e pushimit në kohëzgjatje prej një ore.**

**Pika e katërt (4) - Informatë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për funksionimin e Kuvendit të Komunës në tre mujorin e parë të vitit 2024.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Tani të nderuar-a anëtarë-e të Kuvendit të Komunës, unë në diskutimin tim për ‘Informatën për punën e Kuvendit të Komunës në periudhën janar-mars 2024’ dhe ‘Propozimin për ndryshim-plotësimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024’, do t’i bëjmë bashkë diskutimet, nëse edhe ju pajtohemi në parim, sepse këto dy pika ndërliidhen ndërmjet tyre. Në informatën për punë tremujore të Kuvendit të Komunës, përshkruhen vendimet më të rëndësishme që i kemi marrë sikur janë: rritja dhe bartja e buxhetit të komunës, lirimi i bizneseve nga taksat komunale, subvencionimi i fermerëve pa participim, shqyrtimi në parim i Projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, shqyrtimi në parim i Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë dhe në fund është shqyrtimi dhe analizimi i Raportit të Punës për funksionimin e Kuvendit të Komunës për vitin 2023. Po ashtu e kemi mbajtur edhe një mbledhje solemne të Kuvendit të Komunës, për nderë të Ditës së Pavarësisë së Kosovës. Krejt në fund të informatës tonë i kemi paraqitur edhe sfidat

tona, që po na përcjellin me mos publikimin e audio - incizimit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, vendosja e pyetjeve dhe përgjigjeve parlamentare në fund të rendit të ditës, pastaj në mbledhjen e fundit edhe heqja e tyre nga rendi i ditës, prej nga vjen edhe 'Propozimi nga ana ime për ndryshim-plotësimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024', meqë me plan të punës pyetjet kanë qenë në fillim, po ashtu kam kërkuar që të rritet seriozitetit të Ekzekutivi i Komunës, për shqyrtimin përfundimtarë të rregulloreve komunale të miratuara në parim në fund të vitit 2023, të cilat i kemi përgatitur të gjitha Grupet Punuese në Prevallë, nga të cilat asnjëra nuk kemi arritur ta miratojmë në Kuvendin e Komunës, andaj ju informoi se në fund të vlerësimin e performancës nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ne si Kuvend i Komunës mund të dalim keqë, për secilën rregullore janë Grupet Punuese, ju e dini vetë rrjedhën e diskutimeve që e kemi patur të rregullorja për ndarjen e subvencioneve, me kriteret dhe poentim të aplikuesve për subvencione, sipas kriterëve bazike për vlerësimin e tyre. Një çështje mjaftë sfiduese për neve mbetet informimi i opinionit për punën tonë, pra jemi duke mos e respektuar në plotëni edhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, sepse nuk publikohet incizimi live i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, andaj tani kjo qasje e Ekzekutivit të Komunës duhet të ndryshon dhe të kryhet kjo punë, që bjen në kompetencën e tyre, krijimi i kushteve për mbarëvajtjen e punës së Kuvendit të Komunës dhe informimi i plotë i qytetarëve për këtë punë.

**Miranda Shabani:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne e kemi shqyrtuar dhe analizuar materialin e përgatitur në formën e 'Informatës për punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës në tre mujorin e parë të vitit 2024', ku është mbajtur një mbledhje solemne e Kuvendit të Komunës, për shënimin e Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Grupi Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, pajtohet që duhet të eliminohen këto probleme të vogla, të zhvillohet demokracia në kuptimin e saj të plotë. Janë marrë vendime të rëndësishme për interesin e qytetarëve të komunës tonë, po ashtu është e rëndësishme që janë rritur të hyrat vetjake për 111%, është bërë bartja e buxhetit të pa shpenzuar në vitin 2023, për shpenzim në vitin 2024, bizneset e komunës tonë janë liruar nga taksat komunale, po ashtu e kemi marrë edhe vendimin për subvencionimin e fermerëve të komunës tonë, pa participimin e tyre, e kemi hequr atë, kemi votuar këtu në Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës shumicën e vendimeve të përbashkëta, me partnerët e koalicionit që i kemi në Kuvendin e Komunës, me synimin e vetëm që të lehtësojmë jetën e qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës. Jemi të hapur për bashkëpunim me të gjithë për mbarëvajtjen e punës së Kuvendit të Komunës.

**Aida Alimi:** Unë e kam një vërejtje të puna për rregulloret komunale, ku puna me shumë grupe nuk ka qenë produktive, nëse grupet e caktuara punuese nuk punojnë, atëherë Kryesuesit e këtyre Grupeve Punuese duhet të ndërrohen, nëse nuk bëhet funksionalizimi, përfundimi dhe zbatimi i këtyre rregulloreve, atëherë mjetet financiare të shpenzuara për këto çështje me rëndësi publike kanë shkuar dëm.

**Vlonjat Hasani:** Ne e kemi një material kryesor prej dy faqeve, me përshkrim të disa vendimeve të marra në Kuvendin e Komunës, që ne i dijmë, sepse jemi pjesëmarrës në shqyrtimin e tyre, dy faqe do të duhet të shkruhen vetëm për sfidat e Kuvendit të Komunës, për punën në këtë tre mujorë i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës është dashur të jenë së paku pesë faqe tekst. Kuvendi i Komunës nuk është i përfshirë në zhvillimet dhe gjërat që ndodhin në komunë, pastaj radhitja e gjërave për punën e Kuvendit nuk është bërë si duhet, ne kemi kërkuar subvencionimin e nënave lehona, kjo punë nuk përmendet fare në raportin e punës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Kjo punë nuk është përfshirë në raportin e punës, sepse nuk ka ndodhur në muajin mars 2024, meqë mbledhja e këtij muaji, është shtyrë për arsye të bartjes së buxhetit, ajo është mbajtur në fillim të muajit prill 2024, ku ka ardhur edhe ky propozim i Lëvizjes Vetëvendosje, por është jashtë periudhën tonë raportuese.

**Vlonjat Hasani:** Sfidë për neve është kjo që po ndodh sot, pra ndërprerja dhe vazhdimi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës, për arsye të largimit të pikës ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, mungesës së kushteve bazë për mbajtjen e mbledhjeve, ku po shkelet neni 43.4, i Ligjit për gjuhët dhe shpalljet publike, po shkelet po ashtu Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019, neni 8, pika 3, pika 5 dhe pika 6, që flet për arkivimin dhe qasjen e përdorimit, kush është këtu përgjegjës, kush e detyron dikën për një veprim Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, këtë e definon neni 9. Ju në këtë informatë kërkon ruajtje e gjuhës parlamentare nga ana e të gjithë neve, këtu ka shumë hapësirë për përmirësime, por ato duhet të fillojnë nga ju dhe Ekzekutivi i Komunës, duhet të krijohen kushtet për punë normale në mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

**Mirsad Qyqalla:** Unë e kam lexuar këtë informatë dhe propozimin, këto sfida ne i kemi për dy vite, meqë Ekzekutivi i Komunës nuk krijon kushte për punën e Kuvendit të Komunës, mbledhjet e Kuvendit të Komunës janë të planifikuara, e kanë një kalendar kohor, kanë afate ligjore, por çka ndodh te ne, njëherë pyetjet vendosen në fund të rendit të ditës, pastaj hiqen krejt nga rendi i ditës, me tendencë që të mbyllet debati, ku ngriten problemet dhe shqetësimet e qytetarëve, për çështje të ndryshme jetike për jetën e tyre, ju jeni shkëputur nga puna në teren, andaj vijnë këto probleme dhe sfida për ju, duke tentuar ta mbyllni gojën e opozitës.

**Hasan Ismajli:** Unë e kam lexuar këtë informatë për punën tonë, kam qenë në grupet punuese, ne e kemi përgatitur Rregulloren për varreza dhe mirëmbajtjen e tyre, në Shqipëri, e cila pastaj është miratuar në Kuvendin e Komunës, para një viti, por nuk po gjen zbatim, prapë vazhdohet me vendime, vitin e kaluar i kemi marrë dy vendime për shpenzimet e varrimit, për dy periudha kohore të vitit, duke shpresuar se rregullorja e miratuar do të gjen zbatim, ndërsa këtë vit shpenzimet e varrimit po bëhen me vendim të Kryetarit të Komunës, duke e anashkaluar Kuvendin e Komunës nga vendim marrja. Kemi punuar në rregullore tjera mbi gjashtëdhjetë veta, anëtarë të Kuvendit të Komunës, Ekzekutivit të Komunës dhe zyrtarët komunal, janë hartuar projektet e para për shtatë rregullore, i kemi shqyrtuar dhe miratuar në parim në fund të vitit 2023, por ato rregullore tani nuk janë askund, sepse nuk po procedohen për shqyrtim përfundimtarë nga ana e Ekzekutivit të Komunës.

**Nënkryetari i Komunës:** Unë projektet e këtyre rregulloreve i kam dërguar te secili drejtor dhe shumë shpejtë ato do të procedohen për shqyrtim dhe miratim përfundimtarë, disa prej tyre kanë nevojë të rregullohen në një apo dy nene në përmbajtjen e tyre, unë për këtë punë i kam dy sugjerime, rregulloret komunale duhet të hartohen fillimisht nga ana e Drejtorive përkatëse, pastaj pas miratimit në parim të kuqen anëtarët e Kuvendit të Komunës, nëpërmjet Grupeve Punuese, sepse është i definuar shumë qartë roli i Administratës në vendim marrje. Lidhur me ceremonitë të caktuara dhe organizime tjera publike, unë nuk e ftoi askënd, këto janë lajme të drejtorive komunale për aktivitetet e tyre, nuk e obligoi askënd të vijë, informimi ka qenë, në këtë aktivitet ka qenë pjesëmarrës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Shefi i Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, varësisht prej natyrës së aktivitetit dhe organizimit të caktuar, mund të ftohen njerëzit nga përgjegjësitë, edhe Shefat apo anëtarë tjerë të Kuvendit të Komunës. Rregullimi i mikrofonave është punë e Drejtorit të Drejtorisë së Administratës, unë po të isha Kryetar i

Komunës, ai nesër nuk do të hynte në komunë më si drejtor, por Kryetari i Komunës këtu është tjetër kush, personi është i emëruar nga dikush tjetër. Tani në bazë të rrjedhës së regjistrimit të popullsisë Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, pritet të ketë 31 anëtarë në mandatin e ardhshëm zgjedhor.

**Hasan Ismajli:** Fjalën unë e kisha për takimin e juaj lidhur me Stadiumin e Qytetit, sepse stadiumi i qytetit tonë nuk është as i Lidhjes Demokratike të Kosovës, as i Lëvizjes Vetëvendosje, por as i Ekzekutivit të Komunës, normal që ne i gëzohemi secilit projekt publik që krijon kushte më të mira për sportistët dhe futbollistët e komunës tonë, në këtë rast, por nuk është detyrë e zyrtarëve, që të bëjnë fushatë kështu.

**Nënkryetari i Komunës:** Tani këtu unë nuk i dërgoi ftesa askujt, këtu të gjithë jemi të barabartë të marrim pjesë, nëse na fton Drejtoria përkatëse në organizimet e saj, edhe këto zyre këtu, edhe Stadiumi është i komunës, investimi është publikë, i planifikuar me buxhet, investimi aty do të zhvillohet në fazë në dy vite buxhetore, nuk është me rëndësi fotografia, por krijimi i kushteve për futbollistët e komunës tonë.

**Mirsad Qyqalla:** Të presim kur fillon shfrytëzimi i këtij tereni nga futbollistët, jo ideja e juaj, kjo tendencë e juaja dhe qasja përjashtuese nuk ju dërgon askund, për Stadiumin e Qytetit ka qenë një promovim politikë nga ana e Ekzekutivit të Komunës, i cili nuk justifikohet, as nuk është çështje e neglizhencës apo ndonjë lëshimi. Unë e kam një kërkesë që 'Rregullorja për Shëbime Publike', e miratuar në Kuvendin e Komunës të gjen zbatim në teren dhe të përmbush ndonjë nevojë të qytetarëve, ju i keni hequr edhe pyetjet nga diskutimi, për t'i ikur adresimit të kërkesave të qytetarëve për shërbime më të mira publike, nga ana jonë si përfaqësues të zgjedhur.

**Laureat Gojnovci:** Tani debati për urimin e fillimit të punimeve në Stadiumin e Qytetit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë, për sqarimin tonë, aty askush nuk ka pasur ftesë, as Kryetari i Komunës, as Nënkryetari i Komunës, as ne nuk jemi ftuar nga askush, e kemi parë këtë si organizim të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe kemi shkuar vetë, me interesimin tonë për këtë punë, aty nuk ka qenë i përjashtuar nga pjesëmarrja asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës, pa përjashtuar këtu edhe opozitën, sepse kemi të bëjmë me një interes të veçantë, për të cilin ne kemi marrë vendim edhe në Kuvendin e Komunës, sepse kjo pronë është nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, andaj dua të ju informoi juve kolegë se Grupi Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës këtu ka shkuar pa ftesë.

**Vlonjat Hasani:** Këtu u fajësua me tone të ashpra Drejtori i Drejtorisë së Administratës, por Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019, përgjegjës për këtë punë e bënë Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, punimet në sallën e Kuvendit të Komunës, është thënë se do të fillojnë ndoshta në vjeshtë, por ju jeni në tre mandate anëtarë në Kuvendin e Komunës dhe kjo gjendje nuk ka ndryshuar në aspektin pozitiv, unë jam skeptikë se këto punime do të kryhen, kjo punë është tentuar të realizohet edhe nga donatorët, por nuk është lejuar nga Ekzekutivi i Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi edhe një çështje që është pengesë për neve, sepse tani me ligjin e ri të pagave, nuk ka mundësi të paguhet anëtarët e Komitetit për Komunitete që nuk janë anëtarë të Kuvendit të Komunës, por as anëtarët tjerë të Komiteteve tjera profesionale, i arsimit, shëndetësisë dhe bujqësisë, andaj e ftojme Ekzekutivin e Komunës, që në aspektin e programeve buxhetore ta gjen një zgjidhje për këtë çështje të pagesave.

**Nënkryetari i Komunës:** Buxheti i komunës ka mundësi të realizon punë dhe aktivitete të ndryshme, deri tani kemi pasur probleme me mirëmbajtjen e kontratave të realizuara, si për

ndriçimin publikë, edhe kjo punë ka problem me ekzekutimin e saj, me donatorë kjo punë nuk lejohet të bëhet, i kemi dhënë prioritet kësaj procedure, unë i respektoi qëndrimet e juaja publike, por politikisht unë këtu jam Kryetar i Degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe do të kemi ballafaqim politikë dhe profesional, por me argumente, e jo me perceptime, tani puna e Kuvendit të Komunës është jo transparente, por ju duhet të punoni të gjithë për hapjen e tij, duhet të bëhet publikimi online i mbledhjeve për ta rritur performancën tonë në vlerësimet e ardhshme.

#### **Pika e pestë (5) - Propozim për ndryshimin-plotësimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Tani unë e kam propozuar ndryshim-plotësimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës, por kjo punë së pari duhet të diskutohet në grupin punues, poenta ime ka qenë që të shtyhen përpara edhe rregulloret komunale të miratuara në parim në fund të vitit 2023, andaj tani unë e tërheq këtë pikë nga diskutimi tani, secilin ndryshim në plan do ta bëjmë pas konsultimeve paraprake. Kush është që propozimi im për tërhiqet nga shqyrtimi.

U votua me: katërbëdhjetë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej katërbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se ‘Propozimi për ndryshim-plotësimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024’, me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim tërhiqet nga shqyrtimi.

#### **Pika e gjashtë (6) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Fushë-Kosovë.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi në shqyrtimin e dytë ‘Projekt-Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, i cili është unik për shëndetësinë primare, është korrigjuar nga ana e Drejtorisë së Shëndetësisë, andaj tani e ftoi Drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që të na jap sqarime.

**Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Projekt-Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, është punuar në bazë të Ligjit për Shëndetësi nga Këshilli Drejtues i shëndetësisë tonë, në konsultim me Ministrinë e Shëndetësisë, është pra unik dhe në përputhje me kompetencat për shëndetësinë parësore, andaj ju ftoi ta votoni.

**Mirlinda Krasniqi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ky statut është unik, e kemi pasur në shqyrtimin e parë me datën 29.02.2024, përbëhet prej nëntë kapitjeve, me gjithsej 30 nene, që janë shqyrtuar në detaje dhe janë harmonizuar me statutin unik për shëndetësinë primare, nga Këshilli Drejtues i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, në nenin 7 parashihet imunizimi dhe vaksinimi kurativ për eliminimin për mbrojtje nga sëmundjet akute dhe kronike, në nenin 9 është organizimi i shërbimeve në qendrën shëndetësore, mbikëqyrje e tyre është na kapitullin e gjashtë, andaj unë në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ju ftoi që ta votoni këtë statut.

**Durim Hajra:** Në parim ne e mbështetim edhe në shqyrtimin e dytë këtë projekt-statut, por kërkojmë të kemi sqarime të qarta, se ë është unik me statutin e kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë për shëndetësinë primare, sepse mund të na kthehet në rishqyrtim, meqë te pjesa e pozitive, parashihen vende të reja të punës.



**Aida Alimi:** Unë dua të dijë, se a ka mundësi ligjore dhe praktike tani që mamografi i kërkuar nga unë në Kuvendin e Komunës, të funksionalizohet, sepse do të ishte një ndihmë e madhe për mbrojtjen e grave nga parandalimi i hershëm i kancerit të gjirit. Të gjithë e dijmë se Komuna e Fushë-Kosovës i ka disa specifika të veçanta në fushën e shëndetësisë, andaj duhet të jemi më kërkuar në realizimin e çështjeve tona.

**Hasan Ismajli:** Nëse janë bërë ndryshime në këtë Projekt-Statut të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, pas shqyrtimit Ministria e Shëndetësisë e kthen prapa, tani nuk kemi mundësi të kemi pediatër dhe gjinekolog pas pensionimit të tyre, andaj kërkoj që të kemi kujdes në këtë drejtim për harmonizimin e tij, me kërkesat që dalin nga Ligji për shëndetësi.

**Dardane Sogojeva Shala:** Laboratori në Qendrën shëndetësore nuk është funksional njëzet e katër orë, po ashtu kërkojmë që të bëhen edhe zëvendësime në kohën e pushimit të mjekëve dhe stafit përcjellës të tyre.

**Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** Stafi është aty në funksion të punës së tyre, tani radiologun mund ta kemi sipas Udhëzimit Administrativ me Nr. 04/2020, tani në shëndetësinë primare shërbimet shëndetësore të pediatrit dhe gjinekologut kthehen.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për miratim në shqyrtimin e dytë 'Projekt-Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve pjesëmarrës në votim, e miraton në shqyrtimin e dytë 'Projekt-Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë' dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për miratimin e 'Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'.
2. Me këtë statut rregullohet organizimi i punës dhe ofrimi i shërbimeve në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Qendrave të Mjekësisë Familjare dhe Ambulancave të Mjekësisë Familjare.

#### **Pika e shtatë (7) - Shqyrtimi i dytë 'Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi në shqyrtimin e dytë 'Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', ftoi Shefin e Shërbimeve Publike që të na jap sqarime.

**Ejup Qyqalla - Shef për Shërbime Publike:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani e kemi në shqyrtimin e dytë 'Projekt-Rregulloren e Menaxhimit të Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', e kemi mbajtur procedurën e diskutimit publikë ndërmjet dy shqyrtimeve të saj, karakteristike të mbeturinat është ndikimi i tyre në ruajtjen e mjedisit, pra ujit, ajrit dhe tokës, por edhe shëndetit publikë sepse ndikon në eliminimin e sëmundjeve ngjitëse, tani në vitin 2024 kemi një avansim, sepse jemi në bashkëpunim me shumë mekanizma që mirren me këtë punë,

edhe në kuadër të nivelit qendror, tutje menaxhimi i mbeturinave nënkupton edhe klasifikimin dhe ndarjen e tyre, nga kjo punë nëse bëhet si duhet arrihet të bëhet reduktimi i tyre, pastaj ripërdorimi dhe riciklimi i tyre. Në aspektin financiarë dhe menaxherial kjo Kompani është rajonale, ne aty e kemi Komisionin Komunal të Aksionarëve, të caktuar me vendimin e Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës, meqë kështu është ndarja e pozitive të aksionarëve, kjo kompani, pra njësi që operon në territorin e komunës tonë kanë probleme, me rritjen e inflacionit, pastaj rritjen e çmimit të dërgimit të mbeturinave në deponinë e Mirashit, pagat e ulëta të punëtorëve, andaj e kemi propozuar një rritje të tarifës, të cilën e kanë aprovuar edhe disa komuna tjera, por edhe Komuna e Prishtinës si aksionari më i madh në këtë kompani.

**Laureat Gojnovci:** Është e pa drejtë të merret vetëm një segment, ku theksohet se po bëhet rritja e tarifave për amvisëritë, sepse kjo rregullore ka shumë ndryshime krahasuar me vitet tjera, kur është hartuar rregullorja e parë për menaxhimin e mbeturinave. Sektori i menaxhimit të mbeturinave bashkëpunon shumë me GIZ-in Gjerman, tani kemi rritje të çmimeve në shumë fusha, është rritur kostoja e jetesës, për shërbime publike kemi rritje nga Kompanitë që i ofrojnë këto shërbime për qytetarë, përveç fakteve që u cekën më herët në këtë kompani - njësinë për territorin e Komunës së Fushë-Kosovë, duhet të bëhet një organogram i ri dhe të bëhet një ngritje e lehtë e pagave për punëtorët, andaj propozimi për ndryshimin e tarifave, e ka për aprovim përkrahjen e Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

**Durim Hajra:** Ndryshimet nga shqyrtimi i parë dhe takimet e Grupit Punues, lëjnë shumë për të dëshiruar, sepse kjo rregullore është përgatitur nga dy persona Shefi për Shërbime Publike dhe Zyrtari i Lartë për Mjedis, ne lidhur me këtë çështje i kemi vërejtjet tona jo vetëm për tarifën, por kjo punë nuk është bërë nga ekspertët, po ashtu nuk është duke u mbrojtur interesi publike, meqë qytetarëve u rëndohen tarifatat, ndërsa bizneset lirohen nga taksat komunale, ju vetë keni theksuar se jemi një komunë e pasur, pikërisht këtu është vendi që të subvencionohet dallimi në pagesën e tarifave për qytetarë ndaj Kompanisë, respektivisht Njësisë së Pastrimit për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, ne tani këtu jemi kundër, ju kemi përkrahur kur e keni ndihmuar këtë kompani në blerjen e kontejnerëve, pse nuk e bënë këtë punë tani, edhe për ta mbrojtur interesin e qytetarëve.

**Mirsad Qyqalla:** Ju tani e keni mohuar pjesëmarrjen e anëtarëve të grupit punues në shqyrtimin e tarifave të reja, ka munguar informimi për këtë punë, me shumë zell në njëren nga mbledhjet e kaluara e keni bërë lirim nga taksat për 2750 biznese që operojnë në territorin e komunës tonë, në mesin e tyre ka kompani me qarkullim të madh, që e kanë dhjetë fishin e buxhetit të komunës, madje ju këtë falje e keni bërë për tri vite. Tani ne në emër të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, nuk pajtohemi që kjo rritje e tarifave të bëhet.

**Hasan Ismajli:** Muajin e kaluar ju e keni bërë lirim nga taksat komunale për 2750 biznese, për tri vite me një shumë vjetore prej: 1.5 milion euro, ndërsa në regjistrin e Kompanisë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', figurojnë në pagesa vetëm 1300 biznese, pra këtu dallimi është shumë i madh për 1450 biznese, edhe nëse i heqim 450 biznese që nuk gjenerojnë shumë mbeturina, prapë mbesin një mijë biznese të pa përfshira. Ju e keni rastin pas përfundimit të tregut në lagjen e Bresjes, ku mbeturinat aty largohen nga punëtorët fizik të komunës, që janë me projekt, këta kanë pranuar t'i marrin këto mbeturina vetëm pas sigurimit të pagesave, pra pas përfundimit të tregut ditën e martë. Unë nuk do të votoi një propozim ku qytetarëve ju rriten tarifatat, ndërsa bizneset sikur janë marketet e mëdha, pompat e derivateve të naftës lirohen nga taksat komunale, kjo është një gjë e pa kuptueshme për mua, sepse ju jeni ngutur të lironi 2750 biznese nga taksat komunale,

ndërsa ekonomitë familjare, tani po i ngarkoni me tarifa shtesë, kjo mënyrë e qeverisjes është e pa pranueshme.

**Aida Alimi:** Në një zonë të kompleksit banesorë me 73 njësi të banimit, janë vetëm tre kontejnerë, madje ka mos përputhje në vendosjen e tyre ndërmjet kadastrit dhe Kompanisë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', por në këtë rast po penalizohen qytetarët të cilët nuk kanë ku t'i hedhin mbeturinat e tyre.

**Nënkryetari i Komunës:** Vendimi për rritjen e tarifave është jo popullorë, po ata duhet të paguajnë këto tarifa për marrjen e shërbimeve publike, është bërë një kalkulim i kostos së operimit, ku janë marrë parasysh rritja e inflacionit që ka ndodhur në gjithë Evropën, shtrenjëtimi i derivateve të naftës për shërbimin që ofrohet, rritja e çmimit për dërgimin e mbeturinave në deponi nga niveli qendror, me përjashtim të pjesës ku rriten tarifat, kjo rregullore është shumë e mirë në mënyrën e organizimit dhe trajtimit të mjedisit dhe mbeturinave në përgjithësi, duhet të punojmë edhe për trajtimin e mbeturinave inerte si komunë, ku ka shumë për arsye se ne jemi një vend ku ka shumë rrënimë të shtëpive të banimit dhe ndërtime të objekteve të reja banesore.

**Hasan Ismajli:** Unë nuk pajtohem me faktin që ju e keni bërë lirinë për bizneset, ndërsa kur janë në pyetje qytetarët, nuk pajtoheni që të ndahet një pjesë e vogël e buxhetit për subvencionimin e kësaj Kompani që e bënë marrjen e mbeturinave.

**Mirsad Qyqalla:** Edhe në lagjen tonë, ku janë pesë blloqe të banimit kolektivë, kontejnerët janë vendosur me rezistencë, nga bizneset e caktuara, bëhet lëvizja e tyre, unë pajtohem që punëtorët e pastrimit duhet të kenë paga më të larta, po ashtu është rritur kosto e operimit, por politikat e Ekzekutivit të Komunës nuk janë të njëjta për të gjithë, bizneset lirohen, ndërsa qytetarët ngarkohen me tarifa shtesë.

**Drejtori për Teknologji Inovacion dhe Integritim Evropian:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Nuk e di që këtu Grupi Punues, a kanë pasur parasysh edhe Barrën administrative, që kërkohet të pjesa e performancës komunale, ku njëri nga treguesit është dixhitalizimi dhe thjeshtëzimi i procedurave të Administratës Komunale, ku shërbimet administrative do të bëhen pa pagesë, andaj nëse në këtë nuk e bëjmë do të humbim shumë poena në performancën komunale.

**Nënkryetari i Komunës:** Kjo kompani është ndihmuar në të kaluarën nga komuna në blerjen e kontejnerëve, ne do të ndihmojmë dhe krijojmë kushte për zhvillimin e bizneseve, sepse ato gjenerojnë punësim për qytetarët e komunës tonë, por edhe jashtë saj. Mirëmbajtja e ambientit e mbron edhe shëndetin publik nga ndonjë epidemi. Më herët këto shërbime janë ofruar me shumën e mjeteve financiare prej: 4.70€, tani ato propozohet të jenë 6.20€, këtu unë kam propozuar që kjo shumë të jetë vetëm 5.90€, këtë rritje e ka determinuar inflacioni i madh dhe jo stabiliteti financiarë i ndërmarrjes publike.

**Mirsad Qyqalla:** Tani këtu e kemi një mendësi politike, që nuk ka ndërruar fare, këta taksat i vendos në mënyrë selektive dhe sipas interesit të tyre, jo duke u bazuar në mbrojtje e interesit të qytetarëve, këtu në mbledhjen e muajit shkurt 2024, është bërë lirimi nga taksat komunale për biznese me qarkullim prej milionave, madje për tre vite.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për miratim në shqyrtimin e dytë 'Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: katërbëdhjetë vota 'për', pesë vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e miraton në një shqyrtimin e dytë 'Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për miratimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, përfshinë mënyrën e menaxhimit të mbeturinave dhe ndarjen e tyre në territorin e komunës.

#### **Pika e tetë 8 - Shqyrtimi i kërkesës për ndërrimin e anëtarit në Komisionin Komunal të Aksionarëve, në Kompaninë rajonale të Mbeturinave Pastrimi.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim Kërkesën e Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për ndërrimin e anëtarit të saj në Komisionin Komunal të Aksionarëve, në Kompaninë rajonale të Mbeturinave Pastrimi, deri tani anëtarë ka qenë z. Laureat Gojnovci, tani propozohet të jetë z. Jahush Krasniqi.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Kërkesën për ndërrimin e anëtarit z. Laureat Gojnovci me anëtarin e ri z. Jahush Krasniqi, në përbërjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve, në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave Pastrimi'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Kërkesën për ndërrimin e anëtarit z. Laureat Gojnovci me anëtarin e ri z. Jahush Krasniqi, në përbërjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve, në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave Pastrimi' dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për ndryshimin e paragrafit 1 të vendimit Nr. 171, të datës 05.07.2022, nën paragrafit 1.1, për ndërrimin e anëtarit të deritashëm z. Laureat Gojnovci, me anëtarin e ri z. Jahush Krasniqi dhe caktimin e tij, si anëtar në Komisionin Komunal të Aksionarëve, në kuadër të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', që operon dhe ushtron veprimtarinë e saj në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Komisioni Komunal i Aksionarëve vepron në emër të komunës dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
3. Anëtari i Komisionit Komunal të Aksionarëve, e përfaqëson komunën dhe ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e tij, sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe për punën e tij i raporton Kuvendit të Komunës.

#### **Pika e nëntë (9) - Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Shkollës së Futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Shkollës së Futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit që të na jap sqarime.

**Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport:** Ju para vetës e keni materialin e Propozimit tonë të mbështetur në kërkesën e Federatës së Futbollit të Kosovës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shkollës së futbollit, të pishat në zonën e destinuar për aktivitete rekreative dhe sportive, ku nderë

është duke ju bërë Komunës së Fushë-Kosovës, nuk ka implikime financiare për buxhetin e komunës, andaj ju ftoi që ta përkrahni.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Kjo pronë a do të jepet me qiran ë shfrytëzim për Federatën e Futbollit të Kosovës, a do të falet, apo do të mbetet pronë komunale, sepse në fletën poseduese nuk tregon se e kujt do të mbetet pronësia dhe cilat do të jenë përfitimet e Komunës së Fushë-Kosovës, sepse këtu kemi të bëjmë me një donacion.

**Laureat Gojnovci:** Këtu në fillim ky është një investim i mirë për sportin dhe sportistët tonë, pa ndonjë implikim financiarë për buxhetin e komunës, kemi të bëjmë me një projekt gjigantë për futbollin dhe ne shpresojmë që këtu së shpejti aty do të fillojnë punimet, andaj në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim ‘Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Shkollës së Futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël, në ngastrat e cekura kadastrale te pishat’.

**Durim Hajra:** Është për çudi që secilin projekt inovativ, ju e keni në shqyrtim ‘Ad hoc’ ose urgjentë, këtu fjala është për dy ngastra kadastrale me sipërfaqe prej 3 hektarëve, tani ju keni partner politikë që këtë pronë ta jepni në shfrytëzim apo si, kush do të administrojë me këtë pronë komunale, meqë në propozim thuhet se kjo shkollë do të licencohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, sikur secila shkollë tjetër e mesme, ku do të mirren normat për këtë shkollë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfërve, kur nuk ka mundësi buxhetore, në shkresë thuhet se ky është një donacion për Federatën e Futbollit të Kosovës, që përkrahet edhe nga donatorë tjerë, duke e përfshirë edhe Shoqatën Humanitare ‘Jetimat e Ballkanit’, kjo punë është e kotë, ky propozim do të kthehet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, sepse ka shumë pengesa në këtë projekt, është shumë i pa qartë.

**Nënkryetari i Komunës:** Vendimi për shkollën e futbollit është inicuar, për ta siguruar këtë donacion, i cili është i caktuar për Ballkanin Përendimor dhe i përkrahur nga UEFA në pjesën financiare, aplikimi për këtë projekt të futbollit do të bëhet nga Federata e Futbollit të Kosovës dhe për këtë projekt është shumë mirë, që është përzgjedhur të jetë Komuna e Fushë-Kosovës, këtu në këtë fazë kërkohet vetëm të caktohet lokacioni, kërkesa nuk është ne terme teknike, do të jetë aty afër Palestrës së Sporteve, për sportistët, ne kemi propozuar sipërfaqën që do të jetë pjesë e dy ngastrave kadastrale në fshatin Sllatinë e Vogël, në një lokacion shumë të përshtatshëm, pastaj ky aplikacion do të dorëzohet në shqyrtim prej Federatës së Futbollit. Kjo shkollë do të jetë publike me rregulla përjashtuese, këtu do të vijnë nxënës nga i gjithë rajoni nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Serbia, Sllovenia dhe vende tjera. Ky është një model i ngjajshëm sikur është shkolla për Administratën Publike në Malin e Zi.

**Mirsad Qyqalla:** Pyetja ime këtu është pasi që ka ardhur në shqyrtim ky projekt inovativ, a ka ardhur ky projekt edhe dikun tjetër dhe është refuzuar, çka do të votojmë ne këtu sot, dhënien me qira, a do të stërviten këtu vetëm nxënësit e shkollës apo edhe klubet sportive, kjo punë po koincidon edhe me fillimin e punimeve për rindërtimin e Stadiumit të Qytetit të Fushë-Kosovës, a janë këtu punë të ndërlidhur me marrëdhëniet e mira, që i ka kreu i Federatës së Futbollit të Kosovës z. Agim Ademi me Komunën e Fushë-Kosovës, kujt do t’i takon menaxhimi i kësaj shkolle, cili është fitimi i komunës së Fushë-Kosovës këtu.

**Hasan Ismajli:** Këtu prona publike komunale nuk duhet të jepet për një Akademi të Futbollit, pa e patur të qartë si do të funksionon kjo punë, ne i dijmë si funksionojnë Akademitë e Futbollit në vendet evropiane që kanë të ardhura madje edhe me miliarda, ku stërviten gjeneratat e reja, mirëpo

këtu ne kemi të bëjmë me një lokacion të pronës prej 2 hektarëve, a do të ndërtohen aty terene sportive, apo kush çka do të ndërton në atë zonë. U tha se këtu do të vijnë nxënës nga shtetet e rajonit, prej Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë, Serbisë, s' do të vjen askush këtu, a do të paguajnë këta nxënës këtu, nëse është kështu kjo punë, çfarë kërkon atëherë në këtë projekt të madh Shoqata Humanitare 'Jetimat e Ballkanit'. Kush do ta mirëmbanë shkollën dhe objektet tjera sportive, a do të zhvillohet në këtë shkollë vetëm mësimi teorik, kush do ta menaxhoi Komuna e Fushë-Kosovës, apo Federata e Futbollit të Kosovës, apo kjo është vetëm një dëshirë e Kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës, i cili është para penzionimit, njësoi edhe si Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës dhe dëshirojnë ta kenë një pronë afër pishave, ku do të ndërtohen objekte sportive.

**Drejtori për Arsim:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani unë dua të sqaroi disa çështje, sepse e njoh këtë fushë mirë, ku projekt do të përkrahet nga FIFA, do të ndërtohet një Akademi e Futbollit, e cila do të jetë e vetmja në rajonin tonë, me partner Federatën e Futbollit të Kosovës, ky projekt ka patur të zhvillohet në Prishtinë ose në Fushë-Kosovë, këtu do të shkollohen 350 deri në 500 nxënës, me trajnerë ndërkombëtarë, nuk do të jetë Akademi e klubeve të futbollit të Kosovës, sikur janë Akademitë e klubeve të mëdha, si ajo e Bajernit të Munihut. Nxënësit që vijnë këtu në shkollë do ta kenë hotelin e tyre për qëndrim, krejt kjo punë do të garantohet nga fondet e FIFË-s, aty do të ndërtohen edhe terene sportive përcjellëse, do të punësohen rreth një qind veta, do të jetë diçka e ngjajshme me kampin nacional për stërvitje që është në Hajvali. Kjo Akademi e Futbollit do të jetë në shërbim të nxënësve të rajonit, si një shkollë e mesme e futbollit e licencuar.

**Vlonjat Hasani:** Tani unë këtu do të kërkoj sqarime për sipërfaqën e cila në dy ngastrat kadastrale i ka 3.4 hektarë, njëra i ka 1.9 hektarë, ndërsa tjetra i ka 1.5 hektarë, ku donacion nga UEFA dhe FIFA, në cilën pjesë do të ndërtohet nga donatorët e Federatës së Futbollit të Kosovës, ku hyn edhe Shoqata Humanitare 'Jetimat e Ballkanit', kjo është pak e çuditshme, në mesin e këtyre institucioneve të futbollit që janë kredibile, edhe një shoqatë humanitare. Ne e kemi kërkuar qasjen në prona publike komunale, por atë nuk e kemi, ndoshta ky është edhe një investim i mirë, por ne i kemi dyshimet tona.

**Mirsad Qyqalla:** E sqaroi mirë tani z. Fatlum Berisha, i cili është një person që e njej mirë fushën e sportit, këtu kemi të bëjmë me një projekt me miliona për aktivitetet e sportistëve, ku do të krijohet një imazh i mirë, do të punësohen një qind veta, këtu unë nuk po shoh që do të vjen dikush tjetër, ndërsa komuna në atë zonë i ka 3 hektarë tokë dhe do të destinoi ata për sportin, ky është thelbi i çështjes këtu në këtë kërkesë të Ekzekutivit të Komunës.

**Hasan Ismajli:** Unë i njoh kriteret e FIFA-s, aty do të jenë 500 nxënës, do të ketë objekte sportive, zhveshtore, sauna, restourante për ushqim, e tjera, por ne këtu nuk e kemi as projektin ideorë, se si do të duket kjo zonë, andaj nuk dijmë saktë se çka duhet të votojmë, sepse Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit këtë projekt e ka dërguar për shqyrtim të pa kompletuar, kalimi i këtij propozimi pa definim të gjërave është një gabim fatal, sepse aty është caktuar edhe lokacioni për kopshtin botanikë.

**Durim Hajra:** Tani këtu Drejtori për Arsim dha sqarime tjera shtesë për kushtet teknike dhe mënyrën e funksionimit, mirëpo ne i kemi dyshimet tona për mbështetjen e këtij projekti, sepse nuk është i sqaruar në letër nga propozuesi.

**Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani e kemi një projekt për të cilin kërkohet të caktohet lokacioni në dy prona komunale, që gjinden në zonën



e pishave, me destinim për rekreacion dhe sport, aty është një sipërfaqe e përgjithshme prej 3.4 hektarëve, në FIFA, do të aplikon Federata e Futbollit të Kosovës sipas marrëveshjes, por kushti fillestarë për këtë aplikim është caktimi i lokacionit nga Kuvendi i Komunës, ne do ta kemi një bashkëpunim me ta në interesin e përgjithshëm për zhvillimin e sportit.

**Nënkryetari i Komunës:** Për vendime që garantojnë një mirëqeni ju duhet të jeni unik, ne as nuk mund të shesim pronën, as nuk mund ta blejmë, me këtë vendim prona nuk po i jepet askujt, vetëm po caktohet si lokacion për zhvillimin e sportit, ndërsa në fazën e dytë ju do ta keni edhe projektin ideorë për ndërtimin e shkollës dhe objekteve tjera sportive, për zhvillimin e aktivitetit të këtyre nxënësve. Këtu kemi të bëjmë me një donacion dhe caktimi i lokacionit, është hapi i parë, qëllimi i vetëm këtu është që këtë zonë të mirë ta vendosim në dispozicion për sportin, ju e keni parë garën që është zhvilluar për lokacionin e Stadiumit Kombëtarë të Futbollit, në vendin tonë.

**Artan Asllani:** Unë e pranoi se e kam një hezitim këtu, sepse kemi të bëjmë me çështjen e pronës, ka lokacione të tilla edhe në Komunitat e mëdha sikur janë: Prishtina apo Prizreni, ne këtu mund ta hapim derën për një projekt madhështorë të FIFA-së, për sportistët e vendit tonë, ne jemi këtu njëzet e shtatë anëtarë të Kuvendit të Komunës, andaj kur shqyrtojmë çështje të tilla me rëndësi duhet të kemi sqarime të nevojshme dhe të jemi unik në procesin e vendim marrjes.

**Durim Hajra:** Këtu po destinohet një lokacioni, por cilat janë kriteret për aplikim, në këtë projekt të FIFA-s, ne nuk kemi informacione, andaj nuk mund të marrim pjesë në votim.

**Mirsad Qyqalla:** Këtu janë disa pa qartësi, u tha se kjo punë është analoge me kampin nacional të stërvitjeve në Hajvali, u përmend edhe gara për Stadiumin Kombëtarë të Kosovës, por halli ynë është se me këtë investim, po ngarkohet parku aty dhe ne nuk e kemi të qartë, se çka do të investohet, nuk e kemi projektin e shkruar për këtë punë.

**Hasan Ismajli:** Këtu për ndërtimin e këtij objekti me rëndësi publike, duhet të bëhet bashkimi i ngastrave kadastrale, kjo punë nuk është bërë, unë nuk e kuptoi si do ta kaloni, ju këtë kërkesë në FIFA, për mbështetjen financiare të këtij projekti për Akademinë e Futbollit.

**Vlonjat Hasani:** Unë nuk e mora këtu asnjë sqarim, se në pronësi të kujt do të mbetet prona, që caktohet për ndërtimin e objektit sportiv për Akademi të Futbollit.

**Nënkryetari i Komunës:** Ju tani informata për ta votuar këtë propozim keni mjaftueshëm, me hartën Zonale të Komunës, kjo zonë është e paraparë si zonë për rekreacion dhe sport, ne e kemi hulumtuar të gjitha mundësitë tona, ky vend është një vend ideal, afër Aeroportit të Prishtinës, prona aty mbetet pronë komunale, nuk është ajo e ndonjë Drejtorie të Komunës. Këtu organizata e FIFA-së është shumë serioze dhe nuk bënë ndonjë investim pa kompletim të projektit zhvillimor aty, ne sot këtu, do ta marrim një vendim vetëm për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e Akademisë së Futbollit, e cila bëhet për ta përfituar këtë donacion në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës. Ju po thuani se aty gjindet edhe kopshti botanikë, por këtu po ndahet e gjithë sipërfaqja e ngastrave kadastrale, por vetëm pjesa prej dy hektarëve sipas ndarjes gjeodezike të saktë, që do të bëhet nga profesionistët e fushës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e shkollës së futbollit në dy ngastrat kadastrale në fshatin Sllatinë e Vogël', pa tjetërsim të pronës komunale.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe pesë abstenime, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e shkollës së futbollit në dy ngastrat kadastrale në fshatin Sllatinë e Vogël', pa tjetërsim të pronës komunale dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për caktimin e lokacionit në ngastrën kadastrale Nr. P-72514048-00443-1 me sipërfaqe prej: S = 1.9 ha dhe ngastrën kadastrale Nr. P-7252404800443-2 me sipërfaqe prej: S = 1.5, të evidentuara në certifikatën e pronës së datës 23.04.2024, në vendin e emërtuar 'Suvi Breg', në Zonën Kadastrale Sllatinë e Vogël, në pronësi të Komunës së Fushë-Kosovës, për fillimin e procedurës për realizimin e projektit për 'Ndërtimin e shkollës së futbollit', në bashkëpunim me Federatën e Futbollit të Kosovës.
2. Shkolla e futbollit e cekur në pikën një të vendimit, licenohet nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, si shkollë e mesme profesionale për sport, ku regjistrohen 300-500 nxënës nga vendi dhe rajoni.
3. Shkolla e futbollit do të mbështet nga donatorët si federatat kontinentale dhe ndërkombëtare të futbollit: UEFA dhe FIFA, sponzorët dhe donatorët e tjerë të Federatës së Futbollit të Kosovës, për kompletimin e projektit të shkollës dhe hapësirave tjera përcjellëse për zhvillimin e aktivitetit sportiv si: konviktit për fjetje, klasave për mësim dhe ambienteve tjera për rekreacion, me personel mësimdhënës ndërkombëtarë e vendorë dhe njëqind punëtorë të nevojshme për zhvillimin dhe organizimin e aktiviteteve sportive.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për ndarjen gjeodezike të pronës dhe zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit e Pronës dhe Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

**Vazhdimi i mbledhjes së datës 30.04.2024, i vazhduar me datën 13.05.2024, u ndërpre sërish në mungesë të kuorumit në orën 16:50 minuta.**

**Vazhdimi i mbledhjes së ndërprerë me datën 13.05.2024, me datën 16.05.2024 ora 10:00h.**

#### **Pika e dhjetë (10) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Përhëndetje për të gjithë të pranishmit, në këtë vazhdim të tretë të mbledhjes së Kuvendit të Komunës, ju ftoi tani të bëni pyetjet tuaja, ndërsa përgjigjet do të jepen disa këtu në mbledhje, e disa tjera në formën e shkruar.

**Hasan Ismajli:** Përhëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Marrëveshjet dhe Aneks-Marrëveshjet për mbulimin e shpenzimeve të varrimit me prijësit fetarë, propozimi im është që kjo punë të rregullohet ashtu sikur ka qenë praktikë deri tani me vendimet e Kuvendit të Komunës, e jo sikur është vepruar jashtëligjshëm me vendime të Kryetarit të Komunës, kjo punë kështu nuk kalon. Pyetjen e dytë e kam për Grupin Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Nënkyetarin e Komunës lidhur me bursat që ndahen për studentët serbë, ju pyes a ndiheni krenarë me këtë çështje, sepse ato ndahen për studentë, që studiojnë në Universitete paralele të Republikës së Serbisë në Kosovë. Lidhur me asfaltimet në oborre private nga ana e komunës tonë e kërkoi një përgjigje, pse po ndodh kjo punë ende. Për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, pyetja është pse kemi mungesë të kanillave këto ditë, pacientët tonë për një bllob detyrohen të japin nga pesë euro në Ambulanca private stomatologjike. Për

Drejtoreshën e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e kam pyetjen për mbjelljen e drunjëve dekorativ, të cilët tani janë duke u mbjellur në trotuare në lagjen e Dardanisë, po rata po mbillen jashtë planifikimit edhe në disa rrugë tjera, që ndërlidhen më rrugën e Dardanisë. Nga prerja e pishave është dëmtuar pylli për 114 metra kub dru, prej tyre 45 metra kub, janë proceduar për shitje apo ku kanë shkuar, unë nuk e di, kjo punë është bërë pa Komision dhe pa nënshkrim të personit përgjegjës. Për Drejtorinë e Arsimit duhet të kujdeseni që pastrami me batanije të ndërprehet në shkollën 'Daut Bogujevci' në Fushë-Kosovë, ndërsa për Drejtorinë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, e kam një pyetje lidhur me vendimin e Kuvendit të Komunës për Akademinë e Futbollit, ashtu si na është thënë neve, apo më saktë Shkollën e mesme të futbollit, aty ju keni manipuluar, duke thënë se kjo hapësirë do të përdoret për sport, sipas Hartëz Zonale të Komunës, këtë duhet të dini Drejtoria e Kadastrit Gjeodezisë e Pronës, por edhe ajo e Planifikimit Urban, sepse sipas hartës zonale, një pjesë e sipërfaqës aty është për kopshtin botanikë, por aty është ndërtuar edhe objekti sportive në ngastrën kadastrale me Nr. 443/2, kjo sipërfaqe nuk është komplet për sport.

**Durim Hajra:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani kërkojmë një përgjigje nga Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, pse nëpër shkolla tona nuk ka letër A 4, me kurrikulën e Arsimit parashihen aktivitete, kjo gjendje paraqet ngarkesë për mësuesit dhe prindërit. Për organizimet lidhur me Festën e Abetares jashtë objektit shkollorë, kjo punë nuk duhet të lejohet, sepse rriten shpenzimet për prindërit, ju vetëm duhet të shikoni si po veprojnë komunat që qeverisen nga Lidhja Demokratike e Kosovës, sikur është Komuna e Pejës dhe Komuna e Lipjanit, për Drejtoreshën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, tani te laboratorit, analiza e hemogramit nuk mund të bëhet, sepse nuk punon, tani janë edhe sëmundjet viroze të stinës, pyetja është kur pritet të jetë funksional laboratorit, lidhur me një konkurs në shëndetësi, kemi ankesa sepse kanë qenë dy kandidat, njëri prej tyre më ka kontaktuar mua sepse i është bërë padrejtësi, ankesa e tij është refuzuar si e pa bazuar, kërkoi që ky rast të shqyrtohet. Për Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit disa pyetje me duhet t'i përsëris prapë, lidhur me sanimin e dëmtimeve në rrugë, për të cilën është thënë se kemi kontratë kornizë tre vjeçare, pse atëherë sanimin e tyre janë duke e bërë punëtorët e punësuar në Projektin e Karitasit, ose më saktë Drejtoria Komunale. Qentë endacakë janë prezentë në lagjen e Dardanisë dhe në rrugët anësore që ndërlidhen me të, sepse ka shumë mbeturina, ne kërkojmë që të shtohen edhe disa pika të grumbullimit të mbeturinave, po ashtu kërkesë e jona është që të bëhet edhe larja e rrugëve. Për Drejtorinë e Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës, e kemi kërkuar qasjen në dokumente zyrtare, lidhur me pronën të cilës i është ndërruar pronari, nga prona komunale ka kaluar në pronë private, ne e kërkojmë një vendim të gjykatës apo institucioneve për këtë lëvizje, meqë jut ani po e bëni një lloj fushate me pronat në qytet, me fillimin e punimeve në Stadiumin e Qytetit të Fushë-Kosovës 'Ekrem Grajçevci', apo kjo punë ndoshta edhe nuk mund të ecë lehtë, sikur ka ndodhur edhe rasti me pronën në fshatin Miradi e Epërme, për rrugën, sepse këtu prona nuk është komunale, është pronë nën menaxhimin e Agjensisë Kosovare të Privatizimit. Një pyetje e kam edhe për Drejtorinë e Drejtorisë së Infrastrukturës, a pritet të asfaltohet këtë vitë rruga 'Nënë Tereza', nga rrethi deri tek Statcioni i trenit, sepse është e dëmtuar në shumë vende, apo të bëhet ndonjë rikonstruktim dhe sanim i saj, sepse i kemi 6.6 milion euro, të bartura dhe të pa shpenzuara nga buxheti i vitit të kaluar. Një kërkesë e banorëve të lagjes së Nakaradës është për sanimin e gypave të rrjetit të kanalizimit, nëse keni ndonjë kontratë për këtë punë, po ashtu të keni një kujdes edhe

për qasjen në rrugë të personave me nevoja të veçanta, të bëhen disa pjerrina në rrugë të qytetit, sikur janë të rregulluara qasje e tyre në institucione publike. Kërkesë tjetër është problem për varrezat në qytet, që duhet të fillohet të zgjidhet sa më shpejtë nga institucionet komunale.

**Mirsad Qyqalla:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit e kam pyetjen për rregullimin e ndriçimit publikë, ku 50 % e tij është jashtë funksionit, na është thënë më herët nga Ish/Drejtori, se jemi në procedurë të kontraktimit të një Kompanie tjetër, sepse ajo e mëparshmja ka qenë e pa përgjegjëshme. Po ashtu këtu shtrohet pyetja, a ka komuna një listë të zezë për këto kompani të tilla. Tjetër problem është qarkullimi i makinerisë së rëndë në qytet gjatë ditës, sidomos në afërsi të shkollës ‘Mihal Grameno’ në Fushë-Kosovës, ka patur probleme, aty e ka humbur jetën edhe një këmbësorë, aty ka shumë lëvizje edhe të fëmijëve, duhet të merrni ndonjë veprim, në kordinim edhe me Policinë e Kosovës. Mbjellja e drunjëve dekorativ, është mirë që po ndodh, por kjo punë po bëhet në hapësirën publike që është e paraparë për lëvizjen e qytetarëve, pastaj është i miratuar edhe Plani për Mobilitetin e Qëndrueshëm Urban nga Kompania Insi, i cili nuk po gjen zbatim në teren, nga shuma e planifikuar prej: 700,000.00€ për mbjellje të drunjëve, a do të ketë dikun edhe ndonjë mini parkë, sepse ju e keni premtuar këtë punë. Në fshatin Bardh I madh nga projektet e komunës tani janë krijuar shumë pengesa në rrugë, fjala këtu është për rrugën ‘Dituria’, që shkonë te shkolla e fshatit, aty janë vendosur pengesa të mëdha, pa asnjë sinjalistikë. Problem tjetër në fshatin Bardh i Madh janë shtyllat e KEDS-it, ku janë vendosur shumë kablllo të ndryshme, nga Kompanitë që ofrojnë shërbime të internetit, disa prej tyre duhet të hiqen apo zhvendosen dhe të lirohen hapësirat publike në disa pjesë të caktuara. Kemi asfaltime nëpër oborre private, ku dikujt i shkon asfalti deri tek dera, ndërsa dikush pengohet në qarkullimin e tij, ka raste kur njerëzit i kanë hequr dyertë e oborrit dhe asfalti i është shtruar brenda oborrit të tij, ju këto raste i dini cilat janë, kjo punë nuk bënë kështu në këtë mënyrë. Unë këtu dua ta paraqes për shqyrtim edhe një rastë, që e konsideroi se duhet të jetë me prioritet, këtu fjala është për rrugën te Xhami, pra te rruga M9 te biznesi Bini në fshatin Sllatinë e Madhe, ku shqetësim është i kahershëm, kërkoi që këtu të intervenonin dhe ta zgjidhni si problem. Shqetësim tjetër është edhe pastrami i varrezave, që duhet të bëhet, sepse kjo punë është e paraparë edhe me ‘Rregulloren për shërbimet e varrimit dhe mirëmbajtjen e varrezave’, që e kemi miratuar vitin e kaluar në Kuvendin e Komunës. Një fenomen tjetër është edhe lënia e mbeturinave në qytet jashtë kontejnerëve, ne kërkojmë të dijmë ku ka ngecur procedura për themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale, sepse mos themelimi i saj neve si komunë, po na shkakton shumë pengesa në ofrimin efikas të shërbimeve publike komunale.

**Aida Alimi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani në rrugën ‘Gjergj Fishta’ në Fushë-Kosovë ka mungesë të shtyllave, nuk ka ndriçim publikë, andaj kërkoi që në bashkëpunim edhe me KEDS-in të zgjidhni këtë punë, sepse kemi problem edhe me qentë endacakë, të cilët janë shtuar kohën e fundit. Për Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban e kam një pyetje, tani është duke u ndërtuar ana e kundërt e rrugës ‘Dardania’, pra në pjesën tjetër të qytetit, andaj kërkoi që të ndër merrni hapa me kohë, për rregullimin e mirë të rrjetit të kanalizimit, në mënyrë që të mos kemi probleme në të ardhmen. Po ashtu dëshirojmë të dijm cilat janë kriteret për vendosjen e kontejnerëve, fjalën e kam për Kompleksin banesor ‘Linda’, te blloqet 4, 5 dhe 6, ku janë të vendosura 210 njësi të banimit dhe aty janë të vendosur vetëm tre kontejnerë. Për Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit e kam pyetjen për vazhdimin e zhvillimit të dukurive negative, te lokalet

afër Stadiumit të Qytetit, kërkoi që të intervenoni dhe të ndër merrni hapa konkret për kohën e punës aty, sepse për banorët e zonës ka shumë zhurmë.

**Habib Mekolli:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam disa pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, fjala është për faqen e shërbimeve publike, ku para një viti njerëzit kanë mundur të komentojnë për çështjet publike, kur është bërë ndonjë punë e mirë, p.sh. ndërtimi i urës apo ndonjë punë tjetër, tani aty mund të bëni vetëm like. Rruga ‘Pajazit Islami’ në Fushë-Kosovë është shumë e dëmtuar, gropat në rrugë më herët janë mbushur me zhavor dhe kubëza betoni, por punimi i tyre është bërë shumë dobët, ne kërkojmë që kjo punë kur kryhet së paku të bëhet në mënyrë më profesionale. Po ashtu ne këtë rrugë ka telashe edhe me rrjetin e kanalizimit, sepse është bërë një përzierje e rrjetit të kanalizimit fekal me atë atmosferik, që duhet të jenë të ndara, njësoi është edhe me rrugë tjera kryesore në qytet deri te rruga kryesore ‘Nënë Tereza’ në qytet. Tani keni filluar me mbjelljen e drunjëve dekorativ në Sheshin ‘Dardania’, sikur e quani ju për dhjetë vjetë, por e vërteta është që aty e keni bërë përshesh, disa drunjë janë vendosur jo sipas projektit, aty nuk ka as një shenjë të ndalimit ndërmjet rrugës ‘Dardania’ dhe ‘Pajazit Islami’, për orientimin e qytetarëve. Për Drejtoreshën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ne kërkujmë që të jemi të informuar, se kush është menaxher i kontratës, për renovimin e fundit që është realizuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, meqë ky projekt ende nuk ka përfunduar, aty punët nuk janë duke u bërë mirë, andaj kërkujmë që projekti të kryhet si duhet.

**Dardane Sogojeva Shala:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, meqë me profesion jam Inxhinieri e Komunikacionit, të oborri i shkollës ‘Selman Riza’ në Fushë-Kosovë, vendosja e tabelës për pritjen e autobusit paraqet rrezik për nxënësit, ajo ose duhet të vendoset më larg si paralajmërim, sepse aty është udhëkryq dhe rreziku është 100%, sepse aty përparësi kanë këmbësorët. Pyetja ime për Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit, tani është meqë është duke u realizuar projekti kapital për mbjelljen e drunjëve dekorativ, nga disa vende duhet të largohen terasat e vendosura aty në mënyrë ilegale, sepse nga mbjellja e tyre janë duke u zënë trotualet dhe hapësirat e lira për qarkullimin e qytetarëve. Për Drejtoreshën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, pyetja ime është, a ka kontroll Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, sepse kemi dallime në çmimet e barnave, fjala është për barnatoren në fshatin Sllatinë e Madhe, ku sjellja e punëtores aty është shumë e keqe, ku shumë çmime janë për 0.50€ me të larta se zakonisht, andaj kërkoi që ju ose në koordinim me Inspektoratin e Shëndetësisë të veproni, e dijm që është biznes privat, por janë duke u dëmtuar pacientët tonë. Lidhur me rrjetin e kanalizimit në rrugën, te rreth/rrrotullimi për Aeroportin e Prishtinës, aty kanalizimi sa herë që ka shi del në rrugë dhe shkakton rrezik për aksidente, meqë kjo pjesë është në territorin tonë, a mund të veproni ju këtu, qoftë edhe në kordinim me Ministrinë përkatëse të Infrastrukturës, meqë kemi të bëjmë me rrugë magjistrale.

**Vlonjat Hasani:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani unë do ta ri përsëriti pyetjen për rrugën ‘Lumi’ në fshatin Miradi e Epërme, meqë nuk ka asnjë lëvizje, as pas kalimit të periudhës dy vjeçare. E kam një kërkesë të banorëve të rrugës ‘Silifke’ në Fushë-Kosovë, sepse aty është krijuar një kaos nga hedhja e mbeturinave, andaj banorët kanë ankesa dhe shqetësime dhe kërkujmë që të largohet kjo deponi ilegale e krijuar aty. Për Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit, e kemi një shqetësim për operimin e taksive ilegal, të cilët po i dëmtojnë taksitë e rregullt, që i kryejnë

obligimet ndaj komunës, andaj ju duhet të veproni. Qentë endacakë janë duke paraqitur problem të madhë, për njerëzit e moshuar dhe fëmijët, kjo punë po vjen si rezultat i hudhjes së mbeturinave në vende të ndryshme dhe jashtë kontejnerëve. Kërkesë tjetër meqë jemi në pragë të stinës së verës për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, është që të bëhet dezinfektimi në qytet dhe fshatra të komunës. Në fshatin Pomozotin asfaltimi i rrugëve është duke u bërë në prona private, kjo punë tani është shndërruar në fenomen. Për Nënkryetarin e Komunës, e kam pyetjen për pronat komunale, a janë ato sekrete, a ka pasur ndonjë tjetërsim, uzurpim, apo pse nuk na jepen, edhe pse komuna ka marrë dënim për këtë punë. Nga lista e punëtorëve të Projektit të Karitasit, ka punëtorë që nuk vijjnë fare në punë dhe marrin pagë, cila është arsyeja që neve si anëtarë të Kuvendit të Komunës, nuk na jepet kjo listë e punëtorëve, që paguhen nga buxheti i komunës. Pyetja tjetër është sa zyrtarë komunal janë të dënuar dhe ata nuk janë suspenduar apo larguar nga puna. Sa projekte komunale janë të pa përfunduara brenda një viti buxhetorë.

**Fisnik Sllamniku:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Për Drejtoreshën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e kam një kërkesë për mirëmbajtjen e hapësirave brenda oborreve të Ambulantave të Mjekësisë Familjare, tani unë këtu fjalën e kam për objektin shëndetësorë në fshatin Vragoli, sepse këtë punë mund ta kryen personi përgjegjës, ashtu sikur veprojmë edhe ne në shkollë, të ndiqet praktikë e njëjtë. Për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, kërkesa ime është që të shikohet mundësia për rregullimin e Stacionit të Autobusëve, pra pritores në fshatin Vragoli, e cila është e dëmtuar. Për Drejtorinë e Arsimit lidhur me pjesën sanitare të shkollës, rregullimin e çeshmeve, gypave të ndryshëm dhe gjëra të tilla, të kryhen nga punëtorët teknik, njësoi kërkoi që të punohet edhe për aktivitetet jashtë kurrikulare, fotokopjet nëpër shkollë të bëhen me kode, në mënyrë që të zvogëlohet mundësia e keqpërdorimit të tyre, është e vërtetë se mësimdhënësve të ciklit të ulët nga klasa e parë deri në të pestën, ju nevojitet shumë letër, andaj një prej zgjidhjeve është bërja e fotokopjes me kartelë, me kodë. Për Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, në fshatin Vragoli, janë të dëmtuara muret e fushës së sportit, kërkohet që nëse ka mundësi buxhetore, të bëhet një intervenim.

**Doruntina Jashari:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Banorët e rrugës 'Hajrulla Zymi' në Fushë-Kosovë, kërkohet të dijnë kur do të fillojnë punimet aty, sepse kalimi në këtë rrugë është bërë i pa përballueshëm. Po ashtu kërkesa ime tjetër është, që kur kanë pikat të tyre në shqyrtim, në mbledhjet e Komitetit për Komunitete, të jenë prezentë Drejtorët e Drejtorateve të Komunës, si dhe të sigurohet prezenca e përkthyesit në mbledhje, meqë kemi anëtarë të cilët nuk e flasin gjuhën shqipe.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Tani edhe unë në cilësinë e përfaqësuesit të Partisë së Drejtësisë në Kuvendin e Komunës, dua ta paraqes shqetësimin që e ngriti kolegja jonë znj. Aida Alimi, të cilin unë e kam thënë para pesë viteve, për zhvillimin e dukurive negative, të lokalet afër Stadiumit të Qytetit, që korrespondon në këtë rastë të jenë edhe shumë afër Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë, ku zhurma dhe sjellja aty për banorët është e pa durueshme, andaj duhet të veprohet në këtë drejtim nga organet përgjegjëse. Me datën 16 qershor është festa e Kurban Bajrami, andaj ne e kemi një kërkesë për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, që të bëhet kositja e varrezave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e rëndësishme është që kjo punë të bëhet, qoftë nga punëtorët fizik të komunës, në bashkëpunim edhe me njerëzit përgjegjës në Këshillin e Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë, ku tani e kemi një udhëheqës të ri. Për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, dua të kërkoi prej tij, që të merrni masa, për një dukuri të



pirjes së alkoolit në semimaturë dhe maturë, për këtë punë unë e kam edhe një video - incizim, ku fajtor këtu është një mësimdhënës, i cili shihet duke ua dhënë nxënësve këto pije nën tavolinë, ky mësimdhënës është një rastë i keqë, ndaj të cilit duhet të merrë masa disiplinore qoftë nga Drejtoria e Shkollës, apo edhe vetë Drejtoria e Arsimit e Komunës së Fushë-Kosovës.

**Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Po në kohën e fundit ka qenë problem furnizimi me material shëndetësorë, ne muajin e kaluar e kemi shpallur tenderin dhe nëse nuk ka ankesa, pritet të nënshkruhet kontrata dhe kjo punë të rregullohet, te rregullimi i dhëmbëve me bllobë, dihen shërbimet që mund të mirren në Qendrën tonë shëndetësore dhe për këtë punë informimi i pacientëve është i plotë, nga personeli mjekësorë. Tani jemi afër për lidhjen e katër kontratave për furnizim me pajisje mjekësore dhe stomatologjike. Hemogramin prej ditës së hënë e kemi funksional. Lidhur me rastin e konkursit në Qendrën tonë të kujdesit primarë shëndetësorë, ne nuk kemi informata për ndonjë ankesë zyrtare. Renovimi i jashtëm i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, nuk ka përfunduar ende, nuk është bërë pranimi teknik i punimeve, ndërsa menaxhere e kontratës, është zyrtarja e komunës znj. Fatmire Miftari. Lidhur me çmimet e barnatores në fshatin Sllatinë e Madhe, kjo punë nuk është në kompetencën tonë, është në kompetencë të Inspektoratit të Shëndetësisë, andaj ne nuk mund të veprojmë.

**Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani lidhur me pyetjen e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli për shpenzimet e varrimit, vendimi për lidhjen e marrëveshjeve me Bashkësitë Fetare në komunën tonë, është i Kryetarit të Komunës, ne si Drejtori e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit vetëm e bëjmë zbatimin e tij. Pemët dekorative, po thuani se janë duke u mbjellur në trotuare, ky është një projekt i mirë, që e keni kërkuar të gjithë, do të krijon një ambient të freskët, për banorët që jetojnë në zonën urbane të qytetit dhe tani është në fillim të realizimit të tij. Kontrata për mbushjen e gropave me asfaltë tani nuk është funksionale, atëherë kur ne e kemi bërë mbushjen e disa gropave për të lehtësuar qarkullimin e automjeteve, ju i keni dhënë vërejtjet e juaja, ne në aspektin juridikë, e kemi të vetmen mundësi ligjore të veprojmë, sipas rregullave që definohen me Ligjin për Prokurimin Publikë, masat e nevojshme janë ndër marrë nga menaxheri i kontratës, është dhënë rekomandimi për shkëputjen e kontratës dhe lënda është në procedurë. Lidhur me qentë endacakë, këtu kompetencat e komunës për veprim, janë të kufizuara, ne e kemi një kontratë vetëm për kastrimin dhe sterilizimin e tyre, pastaj ata lirohen, qentë endacakë nëse nuk trajtohen në nivel vendi, apo në nivelin Rajonal të Prishtinës, është vështirë të eliminohen, sepse ata po lëshohen edhe nga komunat fqinje. Larja dhe pastrami i rrugëve, ndodh nga punëtorët fizik të projektit, por kur ndërtimi është në kulminacionin e tij, ne e kemi ndarë shumën e mjeteve financiare prej: 80,000.00€. Propozimi për rrugën ‘Nëna Terezë’, aty do të kemi një intervenim urgjentë për mbushjen e gropave me kubëza të betonit, do të veprojmë për sanimin e gjendjes së rrjetit të kanalizimit të hapur në varreza, do të bëjmë sanimin e këtij problemi, për gjashtë muaj me radhë e kemi në Organin Shqyrtues të Prokurimit, në procedurë të vlerësimit të ankesave, pastaj pritet të nënshkruhet kjo kontratë për mirëmbajtje. Puna e lëvizjes së mjeteve të rënda, me pesha të mëdha, nuk është në kompetencën tonë, jemi të kufizuar, këtu duhet të vepron Policia e Kosovës, për zbatimin e vendimeve në teren, për zhvillimin normal të komunikacionit në pjesë të ndryshme të lagjes së Dardanisë dhe sidomos rrugës ‘Hajrulla Zymi’, e cila është shumë e ngarkuar për arsye të ndërtimeve atje, për deri sa nuk krijohet një rreth/rrotullim apo dalje te Pompa ‘Kastrati’, ne do të kemi vështirësi të tilla në komunikacion.

Rruga 'Fehmi Lladrovci' është e liruar prej qarkullimit të mjeteve të rënda, sepse ato kalojnë në rrugën afër Hekurudhës. Lidhur me mbeturinat ka shumë përmirësime, ne si Drejtori e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, i kemi kapacitetet e limituara për veprim, këtu duhet të ndërhyjnë Inspektorati dhe Policia e Kosovës, për të arritur edhe një vetëdijësim më të madh, të qytetarëve të pa ndërgjegjshëm që ndikojnë në degradimin e mjedisit ku jetojnë. Për investime dhe uzurpime të pronës publike, në rrugë magjistrale, duhet të njoftohet Ministria e Infrastrukturës, njësoi sikur duhet të veprohet, edhe për problemin me rrjetin e kanalizimit atmosferik, sepse mirëmbajtja e kësaj rruge është e nivelit nacional. Kemi filluar punën për pastrimin e varrezave, njëherë në fshatin Sllatinë e Madhe, do të vazhdojmë këtë punë edhe në fshatrat tjera të komunës dhe varrezat e qytetit, ku janë edhe varrezat e dëshmorëve dhe martirëve të komunës tonë. Mirëmbajtja e shtyllave të rrymës është në kompetencën e KEDS-it dhe operatorëve ekonomik që kontraktohen prej tyre, sikur u theksua këtu nga anëtarja e Kuvendit të Komunës znj. Aida Alimi për rrugën 'Gjergj Fishta' në Fushë-Kosovë, vendosja e kontejnerëve është realizuar nga komuna në bashkëpunim me Kompaninë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', në katër dhjetë pika të reja, në përputhje me kushtet urbanistike të ndërtesave, janë vendosur edhe pikat për grumbullimin e mbeturinave. Problemet me rrjetin e kanalizimit vijnë edhe për arsye se kanalizimi atmosferik, është i lidhur me kanalizimin fekal në rrugën kryesore, kjo punë nuk duhet të jetë kështu, por është bërë në të kaluarën para shumë viteve, andaj e kemi një gjendje të rënduar në këtë drejtim, ne ua kemi shënuar disa email zyrtarëve të ujësjellësit, por nuk kemi përgjigje marrë përgjigje, si komunë nuk kemi kapacitet për intervenime në raste të tilla. Tani në rrugën e 'Dardanisë' dhe disa rrugë tjera anësore, që ndërlidhen me rrugën në fjalë dhe rrugët tjera kryesore të zonës urbane, do të mbillen 1500 drunjë dekorativ, ju thatë se ato nuk po mbillen në vendet jo të duhura, ne nuk jemi kundër bizneseve dhe zhvillimit të tyre, aty ku ka mundësi do të lirohen hapësirat publike, kjo punë nuk mund të jetë fikse, nga blloku në bllokë, do të shfrytëzohen hapësirat e lira që janë tani në secilën rrugë të qytetit në zonën urbane. Tabela e ndalesës së autobusëve në afërsi të shkollës 'Selman Riza', do të largohet. Me punëtorët tonë fizik që i kemi do të mundohem për aq sa kemi mundësi, të bëjmë eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave, por ato po krijohen prapë në zona të caktuara. Ndërsa për rregullimin e pritores së Stacionit të Autobusëve në fshatin Vragoli, që u cekë këtu nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Fisnik Sllamniku, e kemi tani një kontratë të mirëmbajtjes prej: 90,000.00€ dhe do të intervenojmë edhe në këtë fshat.

**Drejtori për Arsim:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani batanijet me të cilat është pastruar një kohë do të hiqen, e tha këtu anëtari i Kuvendit të Komunës z. Fisnik Sllamniku me shumë të drejtë, se pajisjet për pastrim kanë patur defekte mekanike, batanija është përdorur si xhoker për pastrim që i themi ne. U tha këtu se ka mungesë të letrës A 4 në shkolla, ne tani e kemi lidhur një kontratë për mirëmbajtjen e fotokopjeve, ka patur defekte në fotokopje, e jo mungesë të letrës, sepse ne secilës shkollë ua kemi dhënë letrat për mbarëvajtje të punës. Lidhur me rritjen e shpenzimeve për organizimin e Festës së Abetares jashtë objektit të shkollës, kjo ka qenë një iniciativë e vetë prindërve, ne kemi intervenuar dhe tani organizimet për Festën e Abetares, do të mbahet në secilën shkollë, vetëm brenda objekteve shkollore, apo në amfiteatrin që është te ish/objekti i vjetër i komunës. Lidhur me mirëmbajtjen e pjesë së sanitarisë në objektet shkollore, shëndetësore dhe institucionet tjera publike, ne do të kërkojmë që të lidhet një kontratë kornizë për këtë punë. Është një ide e mirë që fotokopjet nëpër shkolla të përdoren nga mësimdhënësit më kode. Çështjen me pije alkoolike në semimaturë, ne e kemi marrë me shqetësim, kjo punë nuk

duhet të lejohet, as në semimaturë, as në maturë, për nxënës, sepse ata janë të mitur, ndaj këtij rasti pas shqyrtimit do të mirren masa sipas legjislacionit në fuqi.

**Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i pata këtu dy pyetje lidhur me ngastrën kadastrale të 'Pishat' në fshatin Sllatinë e Vogël, atje tani do të ndërtohet një shkollë e futbollit, këtu jemi në fazën e konsultimit të modalitetit për ndërtimin e saj, njësoi jemi në fazën fillestare të punës, edhe për rindërtimin e Stadiumit të Qytetit të Fushë-Kosovës, shumë përgjigje për projektet e Drejtorisë tonë, ju do t'i gjeni në pastime të faqja ime zyrtare.

**Drejtori për Inspektorat:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Shumica e punëve të Drejtorisë tonë janë të ndërlidhura me punët e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, andaj nuk do të përsëris përgjigjet e njëjta që u dhanë këtu në mënyrë të zgjeruar dhe përmbajtësore nga kolegu im z. Ardit Sekiraqa, lidhur me qarkullimin e makinave me tonazhe të rënda, ne kemi marrë disa veprime si komunë, njoftimet tona i kemi dërguar te Policia e Kosovës, por ata kanë refuzuar të zbatojnë, për zbatimin e Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban, kompetente sipas kontratës, është Drejtorja e Planifikimit Urban, tani krijimi i rrugëve njëkahore dhe shënjëzimi i tyre horizontal dhe vertikal është në proces, në kënde prej 90 shkallëve. Kemi shumë ankesa për raste të tilla, u cekë këtu Kompleksi Banesor 'Linda', pas pranimit teknik të objektit mirëmbajtja e tyre për periudhën e caktuar në kontratë, është në përgjegjësi të ndërtuesve, pastaj ajo është punë e vetë organizimit të banorëve, kontejnerët duhet të vendosen sipas lejeve ndërtimore dhe rregullave të saj, por ata janë larguar në raste të caktuara nga vetë banorët. Rasti i dukurive negative tek lokalet afër Stadiumit që u cekë këtu, nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe anëtarja e Kuvendit të Komunës z. Aida Alimi, nuk është në kompetencën tonë, këtë punë unë e kam sqaruar këtu, dihen kompetencat që ka Inspektori i Tregut sipas ligjit, aty tani janë ndërruar pronarët e lokaleve, ata nëse veprojnë në mënyrë të paligjshme, jashtë lejes së punës së veprimtarisë së tyre afariste, duhet të vepron Policia e Kosovës. Lidhur me largimin e terasave, tani kur në rrugën e 'Dardania' dhe në rrugët tjera janë duke u mbjellur drunjët dekorativ, ne do ta marrim edhe një aksion tjetër për lirim të hapësirave publike, ju do të jeni të informuar me kohë. Për hedhjen e materialeve inerte në zona të caktuara, ju duhet të na informoni, kur e shihni ndonjë veprim të tillë dhe ne me Inspektorët tonë të Ambientit do të veprojme.

**Drejtoresha për Bujqësi dhe Zhvillim Rural:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani unë i pata këtu vetëm dy pyetje, për pemë dekorative dhe çështjen e pishave, ku një pjesë e tyre është nën menaxhimin e Agjensionit Pyjor të Kosovës. Për punën e projektit të dezinfektimit, dezinfektimit dhe derratizimit, ne e kemi dhënë propozimin tonë, këtu kërkojmë ta lidhim një kontratë kornizë për periudhën tre vjeçare, për dezinfektimin e hapësirave të hapura, para stinës së verës.

**Drejtori për Infrastrukturë:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e pata një pyetje nga anëtarja e Kuvendit të Komunës znj. Doruntina Jashari, se kur do të fillojnë punimet për asfaltimin e rrugës 'Hajrulla Zyri' në Fushë-Kosovë, tani kjo punë është në procedurën e prokurimit dhe punimet pritet të fillojnë në fund të muajit qershor, me një buxhet të planifikuar për asfaltim me trotare prej: 240,000.00€. për rrugën 'Nënë Tereza', prej rrethit deri tek Hekurudha, kjo rrugë nuk është e planifikuar me buxhet për këtë vitë, do të shqyrtojmë mundësinë e planifikimit të saj, me buxhetin e vitit 2025.

**Nënkryetari i Komunës:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Me 99% të këtyre çështjeve që u ngritën këtu nga ju ne mirremi në baza ditore, me të gjitha këto probleme të qytetarëve tonë. Për

pronat komunale, ato janë publike, janë edhe në listat e Agjensisë Kadastrale të Kosovës dhe ju mund t'i shihni, janë dy adresa për qasje në prona, po thuani po ashtu se e kemi fshehur listën e stafit të punëtorëve të Projektit të Karitasit, ata janë punëtorë në shërbim me kontratë, të lidhur me një operatorë ekonomik, ku me kontratë janë të rregulluara obligimet e palëve kontraktuese. A keni marrë veprime të nevojshme administrative për punëtorët e dënuar në Shërbimin Civil, aty ku kemi mundësi ligjore në veprim, e dini rastin e Ish/Drejtorit të Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, ai është pezulluar nga puna, për kohën sa ka qenë nën masa të organeve shtetërore, në rastin e punëtorëve të kadastrit, ku ju po aludoni, ata e kanë marrë një dënim në shkallën e parë, i cili nuk është i formës së prerë, andaj ne nuk mund të veprim në kundërshtim me dispozitat e legjislationit në fuqi. Çështja e barnatoreve dhe çmimeve të barnave, është punë e tregut të lirë, ne nuk kemi këtu kompetencë për veprime administrative, këtu është një mundësi, që personi i caktuar mund të ankohet në Agjensionin për Mbrojtjen e të Drejtave të Konsumatorëve, kjo është rruga formale që duhet të ndjeket. Për futjen e kompanive të pa përgjegjshme në listën e zezë, këtu komuna si Autoritet kontraktues, nuk e ka këtë të drejtë e veprimit të pavarur, ne kemi kërkuar dhe deri tani e kemi bërë ndërprerjen e tri kontratave, këtu nuk mund të veprim jashtë rregullave që parashihen me ligj. U thanë nga ju, edhe problemet lidhur me organizimet për Festën e Abetares, ne i kemi marrë veprimet tona, ambientet shkollore janë shumë të mira dhe këto organizime të nxënësve dhe prindërve, do të mbahen në objektet shkollore, u sqarua edhe pastrimi me batanije dhe problemet teknike që kanë patur pajisjet e reja për pastrim.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Tani edhe unë kërkoj nga ju që të sigurohet, pjesëmarrja e përkthyesit në mbledhjet e Komitetit për Komunitete.

**Hasan Ismajli:** Unë prapë do të kërkoj llogari për çështjen e subvencionimit të studentëve serb, me akronimin jo kushtetues për vendin tonë Republika e Serbisë. Nuk pajtohem se duhet të përmenden me emra zyrtarët e komunës, sikur u bë kjo këtu në sallën e Kuvendit, nga ana e Drejtoreshës së Shëndetësisë, për znj. Fatmire Miftari si mbikëqyrese e një projekti konkret, edhe unë kam mundur të përmend emrat e dy zyrtarëve, që nuk e kanë nënshkruar bartjen e 45 metrave kub dru, por unë nuk e bëj këtë asnjëherë, jam shumë i kujdesshëm, sepse këtu qëllimi im është të goditet fenomeni i dëmshëm, e jo të përmenden individë të caktuar. Lidhur me suspendimet, ofiqari është suspenduar, ndërsa zyrtarët tjerë që janë në procedurë dhe janë dënuar jo, ata nuk janë në burg, por janë në listën e pagave të komunës.


**Vlonjat Hasani:** Inspektorët Komunal, duhet të dalin në rrugën 'Dëshmori' në fshatin Miradi e Epërme dhe vetë të shohin si bëhet kalimi, i kamionëve me tonazh të rëndë. Një pyetje e kam për Drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës, për rrugën 'Silifke', ku duhet të intervenoni. Po ashtu dua të theksoi edhe një herë dënimet që është duke i marrë komuna jonë, për mos dhënien e dokumenteve zyrtare, kjo punë e paraqet një skandal dhe duhet të shikohet edhe nga ana e prokurorisë, unë nuk e di që cili është qëllimi për mos dhënien e këtyre dokumenteve zyrtare, që sipas ligjit duhet të jenë publike dhe të qasshme.

#### **Pika e njëmbëdhjetë (11) - Të ndryshme.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi pikën 'Të ndryshme', nëse keni ndonjë çështje për diskutim, ndonjëri nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje.  
Vazhdimi i dytë i mbledhjes së datës 30.04.2024, me datën 16.05.2024 përfundoi në ora 12:15 minuta.

Procesmbajtës  
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës  
Ali Ismaili

